



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC
OF KOSOVO




KOMUNA E ISTOGUT/ OPSTINA ISTOK/ MUNICIPALITY OF ISTOG


KRYETARI/PREDSIEDNIK/MAYOR

R A P O R T
I PUNËS SË KRYETARIT PËR PERIUDHËN JANAR- DHJETOR 2019

Dhjetor 2019



**KOMUNA E ISTOGUT
OPSTINA ISTOK**



PËRMBAJTJA

1. HYRJE	4
2. DREJTORIA PËR ADMINISTRATË KOMUNALE.....	7
3. DREJTORIA PËR INSPEKSION.....	14
4. DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA.....	17
5. DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK	22
6. DREJTORIA PËR KADASTËR DHE GJEODEZI.....	24
7. DREJTORIA PËR ARSIM.....	25
8. DREJTORIA PËR KULTURË.....	35
9. DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE HIDROEKONOMI.....	36
10.DREJTORIA PËR SHËNDETËSI	39
11.DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE.....	43
12.ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE	49

I. HYRJE

Udhëheqësi i Komunës

Komuna si njësi themelore e pushtetit lokal funksionon në bazë të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/08), Statutit të Komunës si akt më i lartë i komunës si dhe Ligjeve të tjera me të cilat janë përcaktuar kompetencat dhe fushëveprimi i saj. Me ligjin e përmendur janë përcaktuar struktura dhe organet e pushtetit lokal dhe Komunave iu është lënë hapësirë për formimin e drejtorive, përkatësisht përcaktimit të numrit të tyre. Në këtë kontekst si organe të Komunës në Ligjin për vetëqeverisjen lokale janë përcaktuar: Kryetari si organ më i lartë ekzekutiv, i zgjedhur drejtpërdrejtë nga qytetarët dhe Kuvendit Komunal si organ më i lartë vendimmarrës.

Kryetari i Istog-ut, z. Haki Rugova (LDK), është zgjedhur në zgjedhjet lokale në vitin 2017. Lidhja Demokratike e Kosovës mbanë 11 nga 27 ulëset në asamblenë komunale. Partia e dytë më e madhe me 6 ulëse është AAK, e përcjellur nga PDK me 4 anëtarë të asamblesë, VV me dy anëtar , IQ, SL, RB dhe SM me nga një ulëse. Në kuadër të kuvendit janë themeluar dy komitete obligative: Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete. Komuna e publikon proces verbalin dhe të gjitha aktet e miratuara nga takimi i Asamblesë në ueb-faqen komunale. Komuna e Istogut është e organizuar në 11 drejtori dhe Zyra Komunale për Komunitet dhe Kthim duke shtuar Zyrën e Kryetarit përgjegjëse për obligimet horizontale të komunës.

II. KRYETARI I KOMUNËS

Kryetari është organ më i lartë ekzekutiv, i zgjedhur drejtpërdrejtë nga qytetarët i cili e përfaqëson komunën. Gjatë këtij viti, Kryetari i Komunës, në veçanti, krahas punëve dhe obligimeve të tjera ka shqyrtuar dhe realizuar çështje të rëndësishme nga përgjegjësitë komunale dhe atë:

- Realizimi i projekteve prioritare të përcaktuara nga viti i kaluar dhe realizimi i projekteve të përcaktuara nga ky vit;
- Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme të qytetarëve;
- Organizimi dhe funksionimi i organeve komunale të administratës dhe kompletimi i tyre me kuadro profesionale, në këtë drejtim është angazhim permanent në organizimin dhe sistemin e shërbimit civil në atë mënyrë që qytetarët të kenë qasje më të lehtësuar për kryerjen e shërbimeve komunale
- Hartimi dhe propozimi i Rregulloreve dhe Vendimeve të ndryshme nga fushëveprimi dhe kompetencat komunale, të cilat i janë kaluar Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit për miratim
- Si dhe punët dhe detyrat të tjera të rregullta nga fushëveprimi dhe kompetencat e tij.

Në kuadër të Zyrës së Kryetarit funksionojnë edhe: zyra e integriteteve evropiane, zyra ligjore, zyra e komunikimit dhe informimit, zyra e menaxherit të personelit, avokati publik dhe auditori i brendshëm. Në kuadër të zyrës së integriteteve evropiane dhe zyrës ligjore hartohen planet operative për përmbushjen e prioriteteve për integritete evropiane, ofrohen këshillime dhe mendime profesionale juridike, ofrimi i ndihmës dhe hartimi i projekt-rregulloreve komunale, etj. Në kuadër të zyrës së informimit në mënyrë të rregullt ofrohen informata për opinionin dhe media elektronike dhe ato të shkruara për të gjitha aktivitetet e Kryetarit, Drejtorateve dhe punës në përgjithësi të organeve komunale të administratës si dhe bëhet azhurnimi dhe mirëmbajtja e Ueb faqes së komunës. Në kuadër të zyrës për menaxhimin e personelit mbahen dosjet e të gjithë shërbyesve civil dhe bëhet monitorimi i zbatimit të Ligjit mbi shërbimin civil dhe rregulloreve të tjera nga kjo lëmi. Avokati publik, në pajtim me ligjet pozitive në fuqi mbron interesat e Komunës pranë gjykatave kompetente. Si pikësynim i Kryetarit, meqenëse vitin e kaluar është bërë një punë mjaft e madhe në realizimin e projekteve kapitale të rëndësishme për komunën tonë, si dhe identifikimi i prioriteteve të tjera, ka qenë vazhdimi i këtyre prioriteteve të cilat janë realizuar e që do të paraqiten në vijim në kuadër të raportimeve të drejtorateve përkatëse. Krahas këtyre synimeve të cekura më lartë, Kryetari ka kryer edhe punë të tjera: si kontaktimi me organizata të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare, përfaqësues të OSBE-së, EULEX-it, ICO-së dhe vizitave të ndryshme të niveleve të ndryshme qeveritare që i janë bërë komunës sonë.

Zyra Ligjore- Janë propozuar 8 (tetë) Rregullore Komunale në Kuvendit e Komunës për miratim; Janë nxjerr: Vendime 1066 (njëmijë e gjashtëdhjetë e gjashtë); Kontrata 3 (tri); Marrëveshje 10 (dhjetë); Autorizime 13 (trembëdhjetë); Shkresa të ndryshme 21 (njëzet e një); Është punuar në grupe punuese për hartimin e rregulloreve komunale; Puna në komisione për interëvistimin e kandidatëve për pranim në punë; Puna në grupe punuese për hartimin e planeve të veprimit dhe strategjive të ndryshme; Puna në grupin punues për funksionimin e organeve të administratës komunale; Puna për mbledhjen e të dhënave në fushën e legjislacionit gjatë vitit 2019 për performancën komunale; Përgatitja dhe marrja pjesë në mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe KPF-së; Puna në komisione të ndryshme; Shpërndarja e Gazetave Zyrtare-Ligjeve në organet komunale; Bashkëpunimi-konsulltimi me Drejtorët e Drejtorive si dhe zyrtarët komunal lidhur me zbatimin e ligjeve; Punimi i raporteve të ndryshme; Futja në sistem elektronik e të gjitha lëndëve të kryera; Pjesëmarrja në trajnime; në tryeza të rrumbullakta; në konferenca si dhe janë kryer edhe shumë punë tjera të dhëna nga mbikëqyrësi. **Për Drejtorinë për Administratë:** Janë nxjerr: Vërtetime 13 (trembëdhjetë) ; Vendime 20 (njëzetë) si dhe Shkresa të ndryshme.

Zyra për Integritete Evropiane (ZIE), Zyra për Integritet Evropian (ZIE), ka zyrtarin përgjegjës i cili kryen punët dhe obligimet në përputhje me Rregulloren 08/2011 për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Zyrave Komunale për Integritet Evropian. Zyra në fjalë, mbikëqyrë aktivitetet e drejtorive dhe sektorëve që burojnë nga planet e Veprimit për Partneritet Evropian në përmbushjen e obligimeve nga Programi Kombëtar të MSA-së, si dhe angazhohet në zbatimin e dokumenteve tjera strategjike të MAPL-së, respektivisht të Qeverisë së Kosovës. Në kuadër të përgjegjësi të Zyrës për Integritet Evropian, zyrtari përgjegjës, në vazhdimësi mbikëqyrë hartimin e rregulloreve komunale, për të siguruar se ato janë në përputhje me standardet evropiane. Përgjatë vitit kalendarik, janë përgatitur dy (2) raporte (një në Korrik & një në Dhjetor) për Kryetarin e Komunës dhe MAPL-në. Përveç kësaj, aktiviteti i zyrës është i orientuar po ashtu në hulumtimin e programeve të ndryshme të asistencës së BE-së dhe donatorëve tjerë, për të ofruar mbështetje për qeverisje dhe zhvillim lokal.

Auditori i Brendshëm- Në vitin 2019 Auditimi i brendshëm aktivitetin e kryen në bazë të planit vjetor dhe strategjik që aprovohet nga Kryetari i komunës dhe Komiteti i Auditimit sipas Ligjit

06/L-021 KBFP neni 23 pika 1.2 si dhe neni 25 pika 3.3 .

Gjatë kësaj periudhe janë kryer tri raporte të auditimit si: Menaxhimi pasurive komunale me fushëveprim viti 2018 ,Drejtorja e arsimit me fushëveprim viti 2018- 2019 si dhe Tatimi në pronë viti 2019 .Është në proces të auditimit Menaxhimi i pasurive komunale për vitin 2019 .**Nga raportet finale të auditimit janë dhënë 25 rekomandime të ndryshme të lidhura me gjetjet e hasura gjatë auditimit . Rekomandimet e dhëna nga NJAB janë shqyrtuar në Komitet të Auditimit i cili gjatë vitit 2019 i ka mbajtur tri takime .**

Zyra për informim publik, Të dhënat plasura web faqen e Komunës sipas kategorive: Komunikata të dërguara për media **35**, lajme të publikura në ëeb-faq **120**, ftesa të plasura në web **21**, njoftime të plasura në web **99**, urime të plasura në ueb **5**, konkurse publike të plasura në ueb **90**, vendime të plasura në web janë të gjitha vendimet e kuvendit dhe kryetarit, po ashtu janë të vendosura edhe të gjitha mbledhjet e kuvendit dhe të gjitha mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa. Po ashtu janë të publikuara të gjitha planet dhe strategjitë komunale,raportet e kryetarit, kuvendit, drejtorive komunale si dhe të gjitha raportet financiare. **Aktivitete të përcjellura nga mediat:** Të gjitha aktivitetet komunale përcjellën nga radio dhe televizioni lokal dhe po ashtu shumë kronika nga tereni nga televizionet tjera. Gjatë kësaj periudhe kohore kemi pasur 22 kërkesa për qasje në dokumente zyrtare prej të cilave 21 janë të aprovuara ndërsa 1 nga to është refuzuar. Të gjitha kërkesat janë shqyrtuar më kohë dhe u është dhënë përgjigje.

Zyra e Personelit në komunën e Istogut funksionin në kuadër të Zyrës së Kryetarit, momentalisht në kuadër të kësaj zyre punon vetëm Menaxheri i Personelit. Zyra e Personelit është përgjegjëse për gjithë stafin civil që funksionin në kuadër të komunës,. është përgjegjës për sigurimin e mbarëvajtjes së procedurave të rekrutimit të nëpunësve civil, përgatit konkurset, akt emërimet, kontratat për marrëveshjet e punës, procedon pagat dhe bën mirëmbajtjen e dosjeve të personelit.Udhëheq procesin e planifikimit, vlerësimit dhe rekrutimit të personelit si dhe menaxhon sistemin e informatave për menaxhimin e burimeve njerëzore të komunës, siguron identifikimin e nevojave për trajnimin, arsimimin e burimeve njerëzore, vlerësimi i ndikimit të trajnimeve si dhe sigurimi i trajnimeve adekuate, mbështet punën e komisionit për ankesa dhe parashtrësia dhe komisionit disiplinor, bën vlerësim të rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimeve për të siguruar kryerjen e detyrave të tyre në nivel me standardet e kërkuara.

Avokati publik- Punët-detyrat e punës të caktuara me programin e punës për periudhën raportuese e për të cilat është caktuar mbajtja e shqyrtimit në tërësi janë realizuar.

III. DREJTORIA PËR ADMINISTRATË KOMUNALE

Drejtorja për Administratë Komunale është drejtorja më e madhe dhe me qëllim të realizimit sa më me sukses të përgjegjësi, në fillim është hartuar plani i punës në të cilin janë paraqitur synimet që do të përmbushën në këtë periudhë. Administrata komunale është një segment i rëndësishëm i komunës, ku qytetarët në realizimin e të drejtave dhe obligimeve të tyre kanë kontakte të drejtpërdrejta me pushtetin komunal. Gjatë kësaj periudhe kemi bërë përpjekje që administrata të jetë sa më funksionale dhe në pajtim me standardet bashkëkohore, përkatësisht që qytetarët si në aspektin kohor gjithashtu edhe në aspektin cilësor t'i realizojnë të drejtat e tyre nga përgjegjësitë dhe kompetencat e komunës. Në këtë drejtim veprimtaria kryesisht ka qenë e orientuar në realizimin e synimeve programore, respektimin dhe zbatimin e ligjit, si dhe akteve tjera të përgjithshme juridike si parakushte këto për krijimin e një administrate funksionale dhe efikase, në interes të përmbushjes së kërkesave të përgjithshme dhe individuale të qytetarëve pa dallim përkatësie nacionale, fetare, gjinore dhe racore. Orientimet e tilla sipas planit strategjik të punës dukshëm kanë ndikuar në ngritjen e shkallës së përgjegjësisë në punë, disiplinës në punë, avancimit të metodës së punës dhe efikasitetit në punë. Në kontekst të kryerjes së shërbimeve deri tani nuk kemi pasur asnjë vërejtje nga qytetarët tanë, që do të thotë se sipas vlerësimit të përgjithshëm administrata i përmbushë obligimet e saja në mënyrë korrekte dhe cilësore. Në kuadër të këtij drejtorati për këtë periudhë raportuese janë paraparë edhe këto projekte: "Pajisja e objektit komunal me lift automatik", vlera 24,824.84€, "Blerja e pajisjeve të teknologjisë informative", vlera 10.000€ , "Mirëmbajtja e objektit të administratës", vlera 8,937.45€; "Blerja e softverit për shërbime të administratës komunale" vlera 7,700.00€. Duke pasur parasysh synimet e përcaktuara në fillim të këtij viti, mund të përfundojmë se ato deri tani janë realizuar me dinamikën e përcaktuar dhe në pajtim me planin për këtë periudhë. Sipas organogramit dhe Rregullores mbi përshkrimin dhe sistematizimin e detyrave të punës, ky drejtorat është i ndarë në:

1. Sektori për punë administrative të KK-së, punë të përbashkëta dhe çështje teknike,
2. Sektori i gjendjes civile me zyrat e vendit;
3. Qendra për shërbim të qytetarëve;
4. Arkivi komunal;
5. Zyra e prokurimit publik dhe
6. Zyra për të drejtat e njeriut.

Sektori për punë administrative të Kuvendit Komunal, punë të përbashkëta dhe çështje teknike. Ky sektor ofron shërbimin teknik-administrativ për kuvendin komunal dhe trupat e tij. Në kuadër të këtij sektori përfshihet edhe shpërndarja e materialit dhe përpilimi i shkresave, vendimeve të ndryshme dhe ofrimi i ndihmës juridike për kuvend dhe trupat e tij. Kuvendi komunal, në pajtim me funksionimin dhe kompetencat që ka në bazë të nenit 40-të të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale por edhe përgjegjësi të tjera ligjore dhe planit vjetor, me përgjegjësi dhe përkushtim gjatë kësaj periudhe raportuese, kuvendi komunal ka mbajtur 12 (dymbëdhjetë) mbledhje të rregullta , 3(tri) solemne dhe 11 (njëmbëdhjetë) dëgjime me qytetarë. Gjatë mbajtjes së këtyre mbledhjeve të kuvendit janë trajtuar dhe shqyrtuar gjithsej 107 (njëqind e shtatë) pika të

rendit të ditës, duke llogaritur edhe pikat e zakonshme të rendit të ditës, arsyetimi i mungesave në mbledhje, miratimi i procesverbaleve dhe pyetje nga anëtarët e asamblesë komunale. Për më tepër të gjitha këto pika të rendit të ditës, paraprakisht janë trajtuar dhe shqyrtuar edhe në 12 (dymbëdhjetë) mbledhjet e Komitetit për Politik dhe Financa për të cilat komiteti ka nxjerrë rekomandime dhe i ka dërguar kuvendit komunal për shqyrtim dhe miratim. Është me rëndësi të thuhet se gati të gjitha rekomandimet e KPF-së dërguar kuvendit për shqyrtim janë mbështetur dhe përkrahur në mënyrë unanime, gjë që tregon një bashkëveprim në mes tyre. Ndërkaq, Komiteti për Komunitete gjatë kësaj periudhe raportuese i ka mbajtur gjithsej 12 (dymbëdhjetë) mbledhje. Në vështrim të pjesëmarrjes së anëtarëve në mbledhjet e thirrura, nuk ka ndodhë asnjëherë që për shkak të mungesës së kuorumit të shtyhet mbajtja e mbledhjeve as të kuvendit e as komiteteve edhe pse ndonjëherë ka pasur mungesa të arsyeshme po edhe të pa arsyeshme nga anëtarët e kuvendit dhe anëtarët e komiteteve. Sa i përket punës dhe efikasitetit të kuvendit komunal dhe trupave të tij, gjatë periudhës raportuese kuvendi ka nxjerrë dhe miratuar 69 (gjashtëdhjetë e nëntë) vendime, si dhe 8 (tetë) rregullore. Janë themeluar edhe tri komitete konsultative: Komiteti Konsultativ për Shëndetësi, Komiteti Konsultativ për Arsim dhe Komiteti Konsultativ për Shërbime Publike, që të tria po funksionojnë dhe kanë mbajtur nga tri mbledhje pas themelimit të tyre. Po ashtu në Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal dërgohen të gjitha aktet e miratuara nga kuvendi për secilin muaj për shqyrtimin e ligjshmërisë së të njëjtave. Deri me tani të gjitha këto materiale janë dërguar brenda afatit të caktuar, në të dy gjuhët zyrtare si dhe është marrë konfirmimi nga ministria lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së këtyre akteve. Pas shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve ato janë publikuar në ueb faqen e komunës.

Sektori për shërbimin e gjendjes civile dhe zyrat e vendit. Me qëllim që qytetaret t'i kenë më afër shërbimet e tyre, funksionojnë edhe zyrat e vendit: Zyra e vendit në Banjë, Vrellë, Rakosh, Gjurakoc dhe Dobrushë (Zyra e vendit në Vrellë dhe Dobrushë për momentin nuk janë funksionale). Ku qytetarët mund t'i realizojnë të drejtat e tyre në rregullimin e dokumenteve personale pa pasur nevojë të vijnë në Istog. Tani edhe me anë të e-Kioskave ofrohen shërbime 24 orë, e cila është mundësi e mirë sidomos për njerëzit e punësuar të cilët mund t'i kryejnë shërbimet e tyre edhe gjatë ditëve të festave si dhe në fundjavë. Këto e-kioske janë të vendosura në katër qendra urbane: Istog, Gjurakoc, Vrellë dhe Banje. Në kuadër të punëve të rregullta administrative nga administrata e përgjithshme bëhet regjistrimi në librin amë të të lindurve, të kurorëzimit dhe librin amë të vdekurve. Gjithashtu ushtrohen edhe procedura të tjera administrative siç janë: dhënia e vërtetimeve të ndryshme mbi vendbanimin, gjendjes familjare, martesore etj, pranimi i kërkesave dhe shkresave të ndryshme të drejtuara organeve komunale, vërtetimi i dokumenteve zyrtare, ndihma të rregullta juridike për qytetarët etj.

STATISTIKAT E REGJITRIMIT NË SISTEMIN E GJENDJES CIVILE

LINDJE	1527
1. E rregullt	318
Brenda vendit	246
Jashtë vendit	72
2. Me vonesë	1209
Brenda vendit	521
Jashtë vendit	688

VERIFIKIME	20063
1. Me numër paraprak personal	16895
2. Me gjenerim të numrit personal	3168
RISHKRIM LINDJE	4006
REGJISTRIM I QYTETARIT	121
Me vendim të komisionit për shtetësi	10
Me nenin 31	109
Me dekret të presidentit	2
Me nenin 32	2
Me Vendim 296/2018	0
MARTESA	1051
1. E rregullt	819
2. Jashtë vendit	232
RISHKRIM MARTESE	3604
1. Brenda vendit	3499
2. Jashtë vendit	105
SHKURORËZIME	512
ANULIM TEKNIK	0
NË MES TË DY QYTETARËVE TË HUAJ	1
ME ELEMENT TË HUAJ	463
1. Bashkëshorti i huaj	136
2. Bashkëshortja e huaj	327
Me Vendim 296/2018	0
VDEKJE	538
1. E rregullt	308
Brenda vendit	271

Jashtë vendi	37
2. Me vonesë	182
Brenda vendit	
	48
Jashtë vendi	163
Regjistrim i qytetarit të vdekur	491
Me Vendim 296/2018	0

Lloji i dokumentit

Ekstrakti i lindjes	135909
Certifikata e lindjes	71430
Certifikata e martesës	32208
Certifikata e vdekjes	9328
Certifikata e vendbanimit	16679
Certifikata e bashkësisë familjare	24411
Certifikata e gjendjes martesore	8034
Certifikata e shtetësisë	6127
Vërtetim nga arkiva	7851
TOTALI	311977

Numri i qytetarëve që kanë kaluar regjistrin qendror	56941
--	-------

Arkivi komunal. Për periudhën raportuese të vitit 2019 punëtorët e Arkivit Komunal në Istog, kanë qenë të orientuar në ndarjen dhe klasifikimin e lëndës arkivore, që është krijuar si rezultat i punës së organeve komunale të komunës së Istogut. Në bazë të rëndësisë dhe kërkesave të qytetarëve, prioritet i është kushtuar klasifikimit të lëndës arkivore për të cilën kërkesat e palëve janë më të shprehura. Është klasifikuar lënda arkivore e krijuar në Drejtoratin për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit. Ky material kishte të bënte me leje ndërtimi, leje përdorimi dhe projekte të ndërtimit të objekteve të banimit individual dhe kolektiv dhe është klasifikuar në 9 (nëntë) kuti arkivore. Në muajin shkurt të vitit 2019 është klasifikuar materiali arkivor i krijuar në Drejtoratin për Administratë komunale, që kishte të bënte me çështje statusore të parashtruesve të kërkesave dhe është arkivuar në 8 (tetë) kuti arkivore, kryesisht ishin aktvendime të vitit 2010. Materiali arkivor po i kësaj natyre është klasifikuar dhe arkivuar edhe në marsin e vitit 2019, aktvendimet e klasifikuara janë arkivuar në 7 (shtatë) kuti arkivore. Në 10

këtë material arkivor janë klasifikuar kryesisht aktvendimet për ndryshime statusore të lëshuara gjatë vitit 2011. Në prill të vitit 2019 janë klasifikuar aktvendimet për ndryshimet statusore të lëshuara gjatë vitit 2012, këto aktvendime janë klasifikuar dhe arkivuar në 5 (pesë) kuti arkivore. Me klasifikimin e këtij materiali arkivore jemi marrë edhe në maj dhe qershor të vitit 2019. Materiali i klasifikuar arkivor ka të bëjë kryesisht me ndërrimet statusore të qytetarëve siç janë: ndryshimi i emrit, mbiemrit apo gërmëzimit të emrit. Kjo lëndë arkivore është klasifikuar dhe sistemuar në katër (4) kuti arkivore. Në muajin korrik është arkivuar materiali nga Gjykata për Kundërvajtje në Istog, në tetë (8) kuti arkivore. Në muajin gusht është arkivuar materiali nga Këshilli për Mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në 2 (dy) kuti arkivore. Në muajin shtator dhe tetor është arkivuar materiali nga Lidhja e Sindikatave të Kosovës-Dega Istog, në 7 (shtatë) kuti arkivore. Në muajin nëntor dhe dhjetor është klasifikuar dhe sistemuar i njëjti material nga Lidhja e Sindikatave. Për këtë vit prioritet i është dhënë edhe kërkesave të ndryshme të palëve. Të kësaj natyre ishin 24 (njëzetë e katër) kërkesa të qytetarëve të cilët kanë kërkuar që të iu mundësohet qasje në dokumentacionin arkivor më rëndësi studimi, si dhe për realizimin e kërkesave të tyre personale dhe familjare. Në 6 (gjashtë) raste kërkesave të palëve nuk ka mundur të përmbushet me faktin se ata për realizimin e të drejtës së tyre në pension kanë kërkuar nga ky arkiv që tu jepen të dhëna për stazhin e punës apo librezat e punës. Librezat e punës dhe formularët për regjistrimin e stazhit të punës janë djegur në luftën e fundit. Lënda e kërkuar arkivore i është dhënë në shfrytëzim studentëve për studime shkencore me rëndësi historike dhe kombëtare. Vlen të theksohet se prej muajit gusht prezentë ka qenë një studiues shkencor në materialin arkivor të BVI të arsimit. Kishte kërkesa për gjetjen e lëndës arkivore të çështjeve statusore siç janë: aktvendimet për ndryshimin e mbiemrit dhe çështjeve tjera. Për të dhënat e kërkuara janë lëshuar edhe vërtetimet përkatëse për lëndët e shfrytëzuara arkivore.

Qendra për shërbim të qytetarëve. Përmes kësaj zyre qytetarët më lehtë mund t'i adresojnë kërkesa e tyre dhe të marrin përgjigje. Në këtë kuptim të gjitha kërkesat për të gjitha organet komunale kalojnë përmes këtij shërbimi. Gjithashtu nga kjo zyre udhëzohen të gjithë qytetarët për realizimin e të drejtave të tyre në pushtetin lokal dhe për procedurat e realizimit të këtyre të drejtave. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2019, në këtë shërbim janë pranuar një numër i madh i kërkesave të cilat gjenden në tabelën e mëposhtme të drejtuar të gjitha drejtorateve, kryetarit dhe kuvendit.

I. Shëno, sipas Drejtorateve, numrin e kërkesave për një vit:

Nr.	Drejtorati/Departamenti	Të pranuar	Të arkivuara
001	Kuvendi Komunal	58	84
01	Zyra e Kryetarit	240	175
02	Drejtorati i Administratës	569	540
03	Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër dhe pronë	902	2359
04	Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, Buxhet dhe financa	72	105
05	Drejtorati për Arsim	562	832
06	Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	312	461
07	Drejtorati i Inspektionit	170	43

08	Drejtoreti për ShPMSH	790	566
09	Drejtoreti i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Hidroekonomi	522	626
10	Zyra për Komunitete dhe Kthim	61	17
11	Drejtoreti për Planifikim Urban dhe Mjedis	387	228
12	Drejtoreti për Kulturë, Rini dhe Sport	63	39

Gjithsej:	4.708+6,075 =10,783
------------------	--------------------------------

II. Shëno numrin e dokumenteve të lëshuara/ proceduara për një vit:

Nr.	Lloji i dokumentit	Totali
1	Deklaratë për Mbajtës të Familjeve	210
2	Vërtetime, Legalizime	767
3	Deklaratë të statusit personal të qytetarëve	25
4	Te MAPL-së dhe ministrive tjera të protokolluara	208
5	Ekspedimi i postës Rek. dërgesave në postë- përgjigje nga drejtoratet K.K	535
6	Pranimi i dërgesave nga posta në K.K-Istog	579

Gjithsej:	2,324
------------------	--------------

III. Pagesat e administratës për një vit:

Nr.	Lloji i dokumentit	Shuma(€)
1	Pagesat e Administratës-Palët	4.544
2	Pagesa në Arkë	2,583

IV. Të liruar nga pagesa për një vit:

Të liruar:	1,961
-------------------	--------------

Zyra e Prokurimit Publik. Në kuadër të këtij drejtoreti funksionin Zyra e Prokurimit, e cila ndërmerr të gjitha aktivitetet e prokurimit për komunën, në pajtim me Ligjin mbi prokurimin publik. Gjatë periudhës janar-dhjetor Njësia e Prokurimit, pranë këtij Autoriteti Kontraktues ka proceduar aktivitete të prokurimit të cilat janë të përmbledhura në tabelën e më poshtme.

#	Aktiviteti		Gjithsej
1	Aktivitetet e Prokurimit me procedurë të hapur	110	144
2	Procedura e kuotimit të çmimeve	12	
3	Procedura e negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë	4	
4	Procedura për vlera minimale nën 1000,00 €	17	
5	Konkurs i Projektimit	1	
6	Janë nënshkruar gjithsej kontrata	144	144

Vërejtje: Një aktivitet i prokurimit i publikuar në vitin paraprak (2018) është i përfunduar në këtë vit (2019). Ka të bëjë me aktivitetin “Mirëmbajtja verore dhe dimërore të rrugëve të asfaltuara”, i cili për shkak të ankesave nuk ka mundur të nënshkruhet në vitin 2018.

Zyra për të drejtat e njeriut. Në pajtim me Udhëzimin Administrativ të MALP-së është formuar Njësia për të drejtat e njeriut e cila funksion si njësi e veçantë në kuadër të kësaj drejtorie. Misioni i Njesisë Komunale për të Drejtat e Njeriut është vëzhgimi i respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe reagimi për vënien e tyre në vend, sensibilizimi i qytetarëve për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tyre, përmirësimi i akteve nënligjore komunale, praktikës për zbatimin e këtyre akteve, legjislacionit vendor dhe atij ndërkombëtar nëpërmjet opionencave dhe rekomandimeve si në fazën e draftimit të akteve nënligjore nga komuna, ashtu edhe gjatë zbatimit të tyre dhe gjithë legjislacionit tjetër në fuqi që atakon me të drejtat e njeriut.

Gjatë këtij viti kjo zyre ka realizuar aktivitete të shumta si: aktivitetet për “ 8 Marsin “ Ditën ndërkombëtare të gruas; Tryezë pune e organizuar me GGA, USAID-n - projekti “LEGO” dhe ekzekutivi komunal me temën: “Diskutim për dhënien e rekomandimeve që do të futen në Strategjinë Zhvillimore Komunale”. Nxerrja e Rregullores komunale për të Drejtat e Fëmijëve dhe mirëqenjen e tyre, Formimi i Asambles së fëmijëve, “Raportimi për Barazinë e Gjuheve të Qeverisja e Mirë”, “Raporti për OSEB-në, për respektimin e të drejtave të njeriut, Raporti për zyrën e ineqritimeve në komunë, “Raporti i punës gjastë mujoë për MAPL-në, të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore në komunë”, “Raportimi në KKSBNë, “Trajnim dy ditorë me “Demosin”, Tema: “ Rritja e pjesëmarrjes së grave në diskutime publike dhe fuqizimi i tyre në vendimarrje”, Takim lidhur me mekanizmat e dhunës, Tema: Raportim dhe angazhim për mbrojtje të viktimave të dhunës” dhe Fushata me temën: “Njohuri për kancerin e gjirit” në bashkpunim me Drejtoratin e Shëndetësisë dhe USAID-in, projekti “LEGO.

IV. DREJTORIA E INSPEKSIONIT

Në përputhje me Planin e Punës për periudhën raportuese Janar – Dhjetor 2019, të Drejtorisë për Inspeksion, në kuadër të sektorëve përkatës, janë realizuar aktivitete inspektuese në terren si dhe veprime administrative në zyrë, me qëllim të mbikqyrjes së zbatimit të ligjshmërisë dhe rregulloreve përkatëse komunale. Sikurse edhe gjatë vitit paraprak, përmes strukturës së Drejtorisë për Inspeksion janë mbuluar këta sektorë, duke përfshirë sektorin e ndërtimit (me 2 pozita inspektoriale), sektorin sanitar 1 pozitë, sektorin e tregut (1 pozitë), sektorin e mjedisit – ambientit (1 pozitë), sektorin e veterinarisë (1 pozitë – e mbuluar përmes kontratës mbi veprën) dhe sektorin e komunikacionit (1 pozitë – e mbuluar përmes kontratës mbi veprën). Gjatë periudhës raportuese, si rezultat i aktiviteteve inspektuese të realizuara në vazhdimësi në terren, janë arritur rezultate konkrete në mbikqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë, siç është prezantuar në të dhënat vijuese, e që kanë të bëjnë me:

Ruajtjen e brezit mbrojtës të rrugëve regjionale dhe lokale, në territorin e Komunës me ç’rast janë: hartuar 127 procesverbale, janë lëshuar 22 aktvendime, 8 rrethime të objekteve, 40 ri-inspektime, 4 vendime, 2 pezullime të lejes së ndërtimit, 15 përgjigje në bazë të kërkesës së palës, 8 lëndë të proceduara në gjykatë, 8 gjoba mandatare.

Punët e Inspektorit të Ndërtimit- Zona Urbane, Punët e Inspektorit të Ndërtimit për periudhën raportuese janë zhvilluar në bazë të planit të punës janar –dhjetor 2019 të Drejtorisë së Inspeksionit dhe planit operacional të hartuar nga bartësi i pozitës. Aktiviteti inspektues ka qenë i fokusuar dhe i mbështetur në bazë të kompetencave të akteve ligjore në fuqi për pozitën e punës së lartëshënuar dhe ka qenë i fokusuar në :

Inspektime për mbikëqyrje të zbatimit të dispozitave të " Ligjit Ndërtimit" Aktiviteti kryesor i Inspektorit të Ndërtimit ishte parandalimi i ndërtimeve jolegale, kontrollimi, evidentimi , inçizimi dhe ndërmarrja e hapave konkret si në parandalim ashtu edhe në ndjekjen e procedurave ligjore për objektet e ndërtuara si në pronë private ashtu edhe në pronë publike. Aktiviteti i shtuar i Inspektorit të ndërtimit ka rezultuar me ndaljen e ndërtimeve pa leje, me theks të veçant në pjesët urbane të qytetit. Këto masa të inspektorit kanë ndikuar që të shtohen kërkesat për leje ndërtimore dhe legalizim të objekteve banesore dhe afariste. Ku gjatë ketyre inspektimeve në teren nga ana e inspektorit të ndërtimit në katër qendrat urbane Istog, Gurakoc, Banjë dhe Vrellë janë bërë 63 inspektime dhe 107 ri-inspektime , 90 procesverbale , 23 aktvendime ,2 fletëparaqitje për gjykatë dhe 1 gjobë mandatare, 1 vendim për rrënim të mbindërtimit të objektit në Istog duke mos respektuar lejen e ndërtimit nga DUKMM, 3 rrënimë të objekteve ekzistuese. Njoftime për PK, Stacionit Policor në Istog, për asistencë në ndërprerje të punimeve në teren për 4 objekte. Kemi pranuar 63 kërkesa nga investitorët dhe punkruesit e punimeve të objekteve për të bërë inspektimin dhe protokollin mbi përfundimin e të gjitha fazave gjatë ndërtimit siç parashihet me ligj të ndërtimit. Njoftim për Policinë e Kosovës, stacioni policor në Istog për asistencë në ndërprerjen e punimeve për 4 objekte. Po ashtu me 4 kërkesa u janë drejtuar, 2 Drejtoratit të Urbanizmit dhe Mbrotje të Mjedisit , 3 Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi.

Mbikëqyrjen e kushteve higjieniko-sanitare në sektorin e shëndetësisë, tregtisë, hotelërisë, arsimit, gjatë kësaj periudhe raportuese janë zhvilluar këto aktivitete: janë hartuar **89 procesverbale** inspektuese të karaktereve të ndryshme, 29 Procesverbale janë hartuar lidhur me plotësimin e kushteve Higjieniko-Sanitare dhe kushteve tjera minimale-teknike, subjekte këto të cilat kanë filluar ose vazhduar aktivitetin e tyre afarist, 2 Procesverbale janë hartuar duke u bazuar në kontrollen higjieniko-sanitare të restauranteve, 11 procesverbale për kontroll për zbatueshmërinë e Ligjit të Duhanit 04/L-156, 38 Procesverbale në Inspektime të jashtëzakonshme me Polici , Jashtë orarit të punës, 11 Procesverbale për mbyllje të lokaleve dhe vendosjes të etiketës për ndalimin e përkoshëm të punës dhe për ushtrim të aktivitetit të paligjsheëm të punës, 4 Procesverbal për kontrolle tregtare të shitjes me pakicë (Trotuar), 7 Procesverbale lidhur me heqjen e etiketave që ndalojnë ushtrimin e veprimtarisë dhe hapjen e tyre për ushtrim të aktivitetit pas plotësimit të dokumentacionit të kërkuar më herët, 2 Kontrolla higjieniko sanitare në stacionin e autobusave, 4 Kontrolla për paisje me librezë sanitare si **dhe aktivitete rutinore të përditshme të shoqëruara me vërejtje gojore dhe kontrolla tjera për të vërtetuar se a janë plotësuar vërejtjet e dhëna në procesverbale dhe për të cilat aktivitete nuk janë hartuar procesverbale të tjera. Mbikëqyrjen e fushës së tregtimit, qarkullimit dhe ekspozimit të mallrave dhe të shërbimeve, si dhe ligjshmërisë së funksionimit të veprimtarive të tilla biznesore.** janë zhvilluar këto aktivitete: Gjatë kësaj periudhe raportuese janë hartuar **188 procesverbale** inspektuese të karaktereve të ndryshme, 48 Procesverbale janë hartuar lidhur me plotësimin e kushteve Higjieniko-Sanitare dhe kushteve tjera minimale-teknike, subjekte këto të cilat kanë filluar ose vazhduar aktivitetin e tyre afarist, 3 Procesverbale për pranim të kushteve minimale-teknike të refuzuara nga komisioni i pranimit, 19 Procesverbale janë hartuar gjatë kontrollave rutinore inspektuese nëpër marketet dhe supermarketet e shitjes me pakicë të mallrave të ndryshme. Duke u nisur nga vazhda e aktiviteteve të përditshme si dhe nga dukuria e hasur së fundmi në tregjet e Kosovës që ka të bëjë me vendosjen e flamujve mbi origjinën e mallit, 5 Procesverbale janë hartuar duke u bazuar në kontrollen higjieniko-sanitare të restauranteve, 1 Procesverbal për sekuestrimin dhe ndalimin e mallit deri në vërtetimin lidhur me ligjshmërinë e mallit, 8 Procesverbale të kontrolles higjieniko-sanitare në kopshtet e fëmijeve në marrjen e strishëve dhe komentimin e tyre, si dhe marrja e mostrave në bashkëpunim me institutin e shëndetit publik në Pejë lidhur me pastërtinë e ambientit dhe punëtorëve që punojnë me fëmijët, 14 procesverbale për kontroll për zbatueshmërinë e Ligjit të Duhanit 04/L-156, 57 Procesverbale në Kontrolla të jashtëzakonshme me Polici , Jashtë orarit të punës. 25 procesverbale për mbyllje të lokaleve dhe vendosjes të etiketës për ndalimin e përkoshëm të punës, dhe për ushtrim të aktivitetit të paligjsheëm të punës, 5 Procesverbal për kontrolle tregtare të shitjes me pakicë (Trotuar). 8 Procesverbale të Inspektimeve nëpër Furrat e bukës që kanë të bëjnë kryesisht me kushtet higjieniko-sanitare, kontrollat shëndetësore të punëtorëve që punojnë në këto furra të bukës, deklaracionet e bukës dhe çmimet e tyre , kalibrimin e peshoreve etj. Poashtu vlen të theksohet se në të gjitha furrat e bukës së komunës sonë në bashkëpunim edhe me inspektorin regjional sanitar, janë marrë mostrat e bukës dhe janë dërguar për analizë në Prishtinë për të vërtetuar se sa përmban aditiv një bukë dhe se a është aditivi i shtuar në bukë në bazë të normave të lejuara për përdorimin e aditiveve në përgaditjen e bukës dhe produkteve të tjera. 7 Procesverbale lidhur me heqjen e etiketave që ndalojnë ushtrimin e veprimtarisë dhe hapjen e tyre për ushtrim të aktivitetit pas plotësimit të dokumentacionit të kërkuar më herët, 8

Fletëparaqitje të ushtruara prane Gjykatës Themelore për kundervajtje në Pejë,dega në Istog, 2 Kontrolla higjeniko sanitare në stacionin e autobusave, 4 Kontrolla për paisje me librezë sanitare, 3 Komunikime të jashtme për jokompetence, 16 Gjoha mandatore. **Si dhe aktivitete rutinore të përditshme të shoqëruara me vërejtje gojore dhe kontrolla tjera për të vërtetuar se a janë plotësuar vërejtjet e dhëna në procesverbale dhe për të cilat aktivitete nuk janë hartuar procesverbale të tjera. Në sektorin e mbrojtjes së mjedisit - ambientit, gjatë kësaj periudhe raportuese janë zhvilluar këto aktivitete:**

- Janë hartuar **196** procesverbale inspektuese .
- Janë lëshuar 25 Aktvendime.
- Janë shqyrtuar 8 kërkesa të palëve të cilat kanë marrë zgjidhje.
- Janë lëshuar 18 gjoha mandatore.
- 5 fletëparaqitje për gjykatë.
- Angazhimet tjera në komisione komunale me Drejtoritë tjera.

Sektorin e veterinarisë: Gjatë periudhës raportuese inspektori i veterinarisë ka kryer në bazë të kontratës me Komunën e Istogut për shërbimet e mëposhtme: Aktivitetet lidhur me therjen,shitjen dhe qarkullimin e mishit; me ç’rast janë realizuar 487 vizita-inspektime,çertifikata të therjes dhe vulosjes së mishit, 36 inspektime të tregut kafshëve, 24 inspektime të hurdhave të peshkut, 35 Procesverbale me rastin e dëmtimit dhe ngordhjes të kafshëve, 43 Procesverbale të hartuara si pasojë e dëmtimit të kafshëve nga ujku, ariu dhe procesverbalet e hartuara me kërkesën e palës, 1 Procesverbal ,mbytje e kafshëve nga rryma.

Në sektorin e komunikacionit: Aktiviteti inspektues ka qenë i fokusuar dhe i mbështetur në bazë të Ligjit Nr.04/L-179 Për Transportin Rrugor , Rregullores Komunale Nr.5/2014 dhe kompetencave të përshkruara në bazë të marrëveshjes për shërbimet e veçanta ,02Nr.209/2019. Gjatë kësaj periudhe raportuese janë kryer këto aktivitete:

- 31 procesverbale të operatorëve të transportit publik të udhëtarëve me autobus dhe auto-taxi.
- 16 gjoha mandatare të shqiptuara nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës në bashkëveprim me Inspektorin Komunal të Komunikacionit e që kanë të bëjnë me transportin publik të udhëtarëve në relacionin Istog-Pejë dhe Istog-Prishtinë.
- 5 gjoha mandatare të shqiptuara nga Inspektori Komunal i Komunikacionit për shkeljet e Ligjit nga operatorët e transportit publik të udhëtarëve me autobus dhe auto-taxi.
- 21 inspektime, kontrole, ri-ikonrolle të transportit nderurban në relacionin Istog-Pejë , Istog-Prishtinë si dhe të auto-taxsive në relacionin Istog-Vrellë, Istog-Gurakoc dhe Istog –Rakosh.

Krahas punëve dhe obligimeve të planifikuara, në periudhën Janar – Dhjetor2019, kësaj Drejtorie i janë parashtruar edhe kërkesa për realizimin e aktiviteteve të ndryshme inspektuese në terren të cilat kanë marrë përgjegje mbrenda afatit të paraparë ligjor.

V. DREJTORIA PER BUXHET DHE FINANCA

Në fillim të vitit buxhetor 2019 në Thesarin Qendror është dorëzuar rrjedha e planit të parashë për të gjitha programet dhe nënprogramet buxhetore në bazë të planit të shpenzimeve 2019-2021. Të hyrat vetanake janë të përcaktuara me Rregulloren Komunale mbi të Hyrat, në të cilën janë determinuar cilat të hyra ka të drejtë t'i arkëtojë komuna si: tatimi në pronë, taksat për dhënien e lejeve të ndërtimit, taksat nga licencat e lokaleve, taksat e shërbimeve komunale si dhe të hyrat nga dënimet e shqiptuara, në komunikacion etj. Dhënia e shënimeve të përditshme mbi buxhetin dhe shpenzimet buxhetore nga "FreeBalance" Në vijim po paraqesim burimet e financimit të Buxhetit për vitin 2019 dhe mjetet e bartura 2018 në vitin 2019 dhe realizmi i shpenzimeve prej 01.01.2019 gjerë më 26.12.2019.

BURIMET E FINANCIMIT PËR VITIN 2019	PLANI I BUXHETIT 2019	SHPENZIMET BUXHETORE 2019	SHPENZIMET BUXHETORE TË REALIZUARA NË %
1	2	3	4
10.GRANTI QEVERITAR 2019	9,443,276.39	8,495,586.99	89,96%
21.TË HYRAT VETANAKE 2019	1,277,578.00	825,790.99	64,64%
22.MJETET E BARTURA NGA VITI 2018 NË 2019	566,393.10	354,195.76	62,54%
TOTAL: BUXHETI ME MJETE TË BARTURA	11,287,247.49	9,675,573.74	85,72%
31.MJETE BUXHETORE NGA DONATORËT E MBRENSHËM DHE JASHTËM	72,547.21	40,429.89	55,73%
06.FINANC.HUAMARRJE PËR KLAUZ.INVEST. -Ndërtimi i skemës për furnizim me ujë në Komunën e Istogut	5,094,246.00	1,018,849.34	20,00%
61.QEVERIA ZVICRANE	165,490.00	0.00	0,00%
73. USAID	3.18	0.00	0,00%
TOTAL: BUXHETI PËR VITIN 2019	16,827,532.41	10,734,852.77	63,79%

--	--	--	--

Shënim: Në tabelen e mësipërme janë paraqitur të dhënat nga Raportet SIMFK FreeBalance të datës 26.12.2019. Nga shifrat nga tabela shihet trendi i mjeteve të planifikuara dhe të shpenzuara nga buxheti qendror dhe të hyrat vetanake nga niveli lokal 2019 dhe të mjeteve të bartura nga të hyrat vetanake të vitit 2018 në vitin 2019, për këtë periudhë raportuese. Trendi i shpenzimeve dhe përcaktimi i tyre varet kryesisht nga trendi i të hyrave vetanake të arkëtuara të cilat janë kontribut i qytetarëve nga tatimi dhe taksat e ndryshme komunale nga të cilat varet realizimi projekteve parësore të komunës të cilat projekte kryesisht janë në të mirën e qytetareve me qëllim të përmirësimit të kushteve dhe standardin jetësor.

Të Hyrat Vetanake Komunale

Të hyrat vetanake të planifikuara për vitin 2019 janë në shumë prej 1,277,578.00 €. Deri me datë 26.12.2019 janë mbledhur (arkëtuar) të Hyra Vetanake Komunale në shumën prej 1,063,648.83 € në përqindje i bie 83.26 %. Ndërsa shpenzimet nga të hyrat vetanake komunale nga 01.01.2019 deri me 26.12.2019 janë në shumë prej 825,790.99 € ose në përqindje 64,64 %. Janë kryer këto punë dhe detyra të punës: Përpunimi i të Hyrave Komunale dhe ndarja sipas Kodeve ekonomik, Regjistrimi i të Hyrave vetanake në sistemin FreeBalance, Përcjellja e arkëtimit të të Hyrave Vetanake Komunale, Kërkesat për Alokimin e të Hyrave Komunale në Thesarin Qendror, Barazimi i të Hyrave Komunale me Thesarin Qendror, Raportet mujore, tremujore dhe gjashtëmujore të Hyrave Komunale dhe barazimi i tyre, Barazimi dhe menaxhimi i të Hyrave vetanake Komunale sipas Planit vjetor të Aprovuar.

Zotimet, janë Kryer këto punë dhe detyra të punës nga Zotimet e Organizatës Buxhetore-Komuna të Istogut. Janë bërë regjistrimet e zotim/ obligimeve dhe kërkesave të zotuar rreth 3,549 lëndë OUP dhe Kërkesa Zotim për Blerje, lëndëve në sistemin e "FreeBalance". Punët e kryera për Zotimet e lëndëve: Regjistrimi i zotim/obligimeve në sistemin FreeBalance për Programet Buxhetore të Komunës, Punët profesionale, administrative dhe nxjerrja e raporteve për pozitën financiare të Komunës nga Thesari-FreeBalance Punët mbi sigurimin-kontrollin e nënshkrimeve të zyrtarëve përkatës në formularin UOP (CPO), KZB-Kërkesave Zotim për Blerje Konsultimet me Zyrën e Prokurimit dhe dorëzimi i Urdhër Obligimeve UOP (CPO) dhe KZB-ërkesave Zotim për Blerje në Zyrën e Prokurimit për procedim të procedurave.

Shpenzimet

Gjatë periudhës 01.01.2019 deri 26.12.2019 janë kryer të gjitha lëndët kanë ardhur për procesim. Është bërë procesimi dhe futja në sistem 4,503 lëndëve në sistemin SIMFK-FreeBalance, (Sistemi Informativ për Menagjimin e Financave të Kosovës) Rimbushje Petty Cash-Para e Imët 28 lëndë, 70 Mbyllje të Avanseve për Petty Cash-Para e Imët dhe Është bërë pranimi i të gjitha lëndëve nga Zyrtarët e Pranimit dhe Zyrtarët tjerë që janë në lidhmëri me procesin e

shpenzimeve nga Buxheti Komunal. Regjistrimi i Kuponave të shpenzimit pa Urdhër Blerje (UOP) dhe verifikimi i furnitorëve dhe llogarive Bankare të gjithë operatorëve ekonomik. Regjistrimi i Kuponave të shpenzimit të shpenzimeve me Urdhër Blerje që rrjedhin nga procesi i prokurimit(Lëndët që kanë të bëjnë më procesin e prokurimit). Regjistrimi i Kuponave të shpenzimeve të Parave të Imëta (Rimbushja e Parave të imëta-Petty Cash-it) dhe Mbyllja e Avanseve për Petty Cash sipas procedurave të Thesarit.Regjistrimi i Kuponave të Shpenzimit për Shpenzimet dhe Paraja e vogël gjepi për udhëtime zyrtare jashtë vendit.

Pasuritë,Regjistrimi i pasurisë, Gjatë periudhes 01.01.2019 deri 26.12.2019 janë kryer këto punë dhe detyra të punës ,të gjitha lëndët të cilat kanë përfunduar procesimin e pagesave në shumat totale me situacione prej 1,2,3,4,5 dhe 6 situacione janë procesuar 30 lëndë. Pritet të bëhet procesimi dhe futja në sistem e lëndëve të Projekteve Kapitale që kanë përfunduar deri me 26.12.2019 ku procesi i procesimit është deri me 09.01.2020. Të gjitha të dhënat që janë paraqitur me lartë jan ato të datës 26.12.2019 qe do të thot mund të kemi ndryshime dhe plotësime tjera deri më datë 31.12.2019.

Sektori i Financave

Sektori i Financave gjatë kësaj periudhe ka kryer punë në harmoni me planin e punës si dhe punë tjera të cilat janë caktua nga ana e eproritJanë pranuar gjithsejtë rreth 4495 lëndë nga ana e zyrtarit për shpenzime të cilat janë kontrolluar , certifiku dhe janë aprovu për mes se sistemit te Fribalancit pasi qe kompetencat kanë kalu neper Komuna. Gjatë kontrolles si lënde të pa kompletura dhe qe janë kthyer tek personat përgjegjës për tu kompletuar janë 57 lëndë. Të gjitha këto lëndë janë regjistru në një program të exellit per evidencë të njëjtat lëndë janë fotokopju ndërsa origjinali është dorëzuar te zyrtarja për arkivim të lëndëve. Në portokolin e Drejtoratit tonë janë evidentu 82 shkresa të ndryshme. Me kërkesë të palëve për këtë periudhë janë lëshuar gjithsejt 1006 Çertifikata të gjendjes ekonomike për qëllime të ndryshme (për botën e jashtme, për nevoja personale ndihma sociale etj). Gjithashtu janë lëshuar 8776 faktura për pagesën e taksës Komunale për regjistrimin e automjeteve me shumë prej 74454 €. Sa i përket pagave janë përcjellur në Ministrinë të gjitha ndryshimet për Janar Nëntor 2019, janë nënshkruar dhe dorëzuar Listat e pagave për muajt Janar- Nëntor 2019. Ka kalkulim pagat e kshilltarëve të Asamblesë Komunale dhe te anëtarëve të komiteteve të cilat paguhet për periudhën Janar Nëntor dhe janë dorëzuar në Ministri, kalkulimi i pagave të punëtorëve për shërbime të veçanta , janë nënshkruar të gjitha listat e pagave sipas programeve buxhetore për këtë periudhë. Të hyrat nga taksat dhe ngarkesat Komunale që janë inkasuar per mes Arkatares Komunale (Pagesat deri në 10 €) kapin shumen prej 153849.70 €. Zyrtarja per arkivimin e lëndve te Thesarit i ka arkivue te gjitha lendet origjinale qe janë aprovue si pagesa gjithsejt 4495 lëndë.Gjithashtu nga zyrtarja per pranimin dhe portokolimin e fakturave janë portokolue gjithsejt 3461 faktura. Janë hapë gjithsejt 13 petty chash te cilet janë me shumë prej 4400 € , gjithashtu janë rimbush 11 petty chash me vlerë 3793.63 €, si dhe janë mbyll gjithsejt 13 Avansa te hapjes në vlerë 4400€Sektori i tatimit ne prone funksionon ne kuader te Drejtorise per Buxhet dhe Financa, prane Komunes se Istogut.Ne kuder te puneve dhe detyrave te punes gjate periudhes kohore prej 01.01.2019 deri me 26.12.2019 jane kryer keto pune dhe detyra te punes:

Lëshuarja e faturave tatimore për vitin 2019 – per kete vit kalendarik janë lëshuar gjithesejt **11.074** fatura, ato jane: per objekte të palujtshme, per keto kategori: objekte banimi, afarizmi, industriale dhe buqësore;per parcella, per keto kategori: parcella per shtepi familjare, afariste, industriale dhe pyjore.Kete vit per here te pare eshte aplikuar tatimi ne toke, per te gjitha parcellat, pervec parcellave bujqesore. **Shuma e faturuar** - per kete vit tatimor gjithesejt eshte **401.891 €**, prej tyre **333.071 €** jane per objeke, kurse **68.820 €** jane per parcella.**Planifikimi i inkasimit**- Sipas te Hyrave Vetanake Komunale per vitin 2019 eshte parapare te inkasohen nga tatimi ne prone , shuma **prej 364.000 €**.

Shperndarja e faturave- Faturat tatimore per te gjithë tatimpaguesit e tatimit ne prone jane shperndare permes Postes se Kosoves- Njesia ne Istog.Sipas Raportit mbi pranim-dorëzimin e dergesave te faturave të tatimit në pronë për këtë vit, i dates 18.07.2019 nga PK -Njesia ne Istog, gjendja e shperndarjes se faturave është si më poshtë:

Nr.faturave	Shpërndarja	Mbetja	Përqindja
11.071	10.329	745	93,27 %

Mbetja prej 745 faturave te pashperndara eshte si rrjedhoje e nderrimit te venbanimit nga tatimpaguesit si dhe adresat jo te sakta .**Ndërhyrjet në sistemin e tatimit në pronë**- sipas shenimeve të grumbulluara nga tereni dhe ne zyre, për këtë vit janë kryer keto nderhyrje ne sistemin e tatimit ne prone :

- **534** objekte te reja te regjistruara
- **4.904** modifikimi i te dhenave te prone
- **1.051** modifikimi i te dhenave te tatimpaguesit
- **8.445** raste korigjime manuale ne sistemin e tatimit ne prone

Ankesat-gjatë afatit të parashtrimit të ankesave, per kete vit janë pranuar gjithësejt 125 ankesa nga tatimpaguesit. Pej tyre 14 ankesa jane parashtruar per objekte. Komisioni per verifikim, ka kryer verifikimin per te gjitha rastet ne teren dhe permes Leter rekomandimit me shkrim ka kerkuar Aprovimin e 12 ankesave dhe Refuzimin e 2 te tjerave. Per secilin rast jane punuar Vendimet me shkrim dhe eshte nderhyre ne system per korigjimin e ngarksesave tatimore per rastet e Aprovuara. Ndersa jane pranuar, shqyrtuar dhe vendosur 111 ankesa per korigjim te parcellave,per te cillat poshtu jane punuar Vendimet me shkrim.**Kontratat e shitblerjes** se pasurise se patundshme jane evidentuar ne system, gjithesejt **59** kontrata.

Vertetimet - Gjate punes me pale, gjate kesaj periudhe raportuese jane leshuar rreth 13.500 Vertetime nga sistemi i tatimit ne prone, me kerkese te paleve, te cilat sherbejne per nevoja personale (transfer prone, tender , aplikim per subvencione nga bujqesia, aplikim per ndihme sociale etj.) si dhe per regjistrim te automjeteve. **Inkasimi**-gjatë këtij viti inkasimi i tatimit ne prone, sipas muajve, është si më poshtë:

MUAJI	VITI 2019	€
Janar	20.045,15	
Shkurt	15.822,94	
Mars	17.497,97	
Prill	34.304,33	
Maj	47.916,96	

Qershor	48.338,97
Korrik	46.526,62
Gusht	59.826,12
Shtator	33.184,24
Tetor	28.763,74
Nentor	16.097,55
Dhjetor	12.785,94 dt.24.12.2019
Gjithsejt	381.160,53 €

Sipas Planifikimit për të Hyrat Vetanake Komunale, në emër të tatimit në prone për **vitin 2019** janë parapare të inkasohen **364.000,00 €**. Të inkasuara deri me dt.24.12.2019 janë **381.160,94 € ose 104 %** në raport me planifikimin, ndërsa në raport me shumën e faturuar (**401.891 €**) **realizimi është 94 %** për këtë vit kalendarik.

PROJEKTET me participim – 17517 BUXHETIMI-ISTOG

Marrëveshje bashkëfinancimi Projekt:Stabiliteti socio –ekonomik i komunitetve etnike pakicë dhe shumicënë Kosovë”. - ASB dhe PREDA PLUS dhe Shoqata bletare “Melissa”. (9,095.00 + 10,000.00).....**19,095.00 €**

Projekti me kod 72582 –Asfaltimi i rrugës lokale Isuf Nicaj në Muzhevinë (3,000.00 + 8,593.00)**11,593.00 €**

Projekti me kod 72578- Ndërtimi i rrugës Qazim Hakaj në fsh Orroberdë.(1,500.00 + 10,500.00)**12,000.00 €**

Projekti me kod **72583**- Hapja e rrugës maloreSudenice Lugu i Mahallës**7,000.00 €**

Projekti me kod -42075- Ndërtimi i rrugës lokale dhe kanalizimit Sali Sokoli në fshatin Sudenicë....

.....5,000.00 € +35,000.00 € = **40,000.00 €**

Ndërtimi i rrugës lokale “Podguri” në Shushicë të Ulët lagja Metaj 5,000.00 € +21,000.00 € = **26,000.00 €**

Projekti me kod 72611 ASF.RR.XH.CAMAJ RR.LAGJ.AJRZAJ-GJOCI-IMERI BANJE - ..**10,000.00 €**

Projekti me kod 72610 ND.KOLEKT.KRYES.KANAL.FEK.ATMOS.L.BLAKAJ-LLUGE-**16,519.00 €**

Projekti me kod 72609 DRENAZHIMI I VARREZAVE NE FSHATIN STUDENICE -.....**6,200.00 €**

Projekti me kod 72608 ASF.RR.FSH.STARADRAN NE LAGJEN BEQIRAJ -**11,406.00 €**

Projekti me kod 72607 ASF.RR.FSH.STUDENICE NE LAGJEN ZEQRIRAJ-....**8,000.00 €**

Projekti kanalizimi në Serbobran participim me bashkimin evropian -..... **10,000.00 €**

Marrëveshje bashkëfinancimi me Komuna e Istogut“**Rregullimi i hapësirës dhe infrastrukturës rreth Palestrës Sportive**”. (34,510.00 €) - MAPL – Demos(**165,490.00**)= **200,000.00 €**

Total: 377,813,.00 €

VI. DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Gjatë kësaj periudhe personeli i sektorit të ekonomisë është angazhuar në kryerjen e këtyre punëve dhe detyrave si: organizim dhe koordinimi i punëve të sektorit për ekonomi, me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë. Përgaditja e listës së borxheve për ngarkesa vjetore për përdorimin dhe shërbimin e pijeve alkoolike për ndërmarrje hoteliere të parapara me Rregulloren Komunale 1/2019. Përgaditja dhe lëshimi i faturave për ngarkesa vjetore për përdorimin dhe shërbimin e pijeve alkoolike për ndërmarrjet hoteliere në bazë të rregullores komunale 1/2019. Për këtë vit janë inkasuar 980,00 euro nga ngarkesat vjetore për përdorimin dhe shërbimin e pijeve alkoolike. Përgaditja e dokumentacionit për zotimin e mjeteve dhe kompletimi i lëndëve për procedimin e pagesave për projektet kapitale të Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim të planifikuar për vitin 2019 gjithashtu edhe për mallra dhe shërbime. Përgjegje ndaj kërkesave të palëve dhe procesimi i tyre përmes intranetit. Angazhimi në disa raste në komisione për vlerësimin e ofertave të projekteve kapitale. Lëshimi i vërtetimeve bizneseve lidhur me përmbushjen e obligimeve për ngarkesa të afarizmit vjetor.

Në Qendrën Komunale të Bizneseve janë kryer këto punë:

- Regjistrim i bizneseve-----	137
- Shuarje të bizneseve -----	17
- Ndryshime në biznes -----	70
- Informata të biznesit -----	20
- Vërtetim biznesi -----	4
- Çertifikata të reja (NUI) -----	707
- Këshillime për regjistrim të bizneseve -----	226
- Këshillime për ndryshime në biznes -----	228
- Këshillime për shuarje të biznesit -----	112

Duhet të theksohet se me vendim të MTI-së, regjistrimi i bizneseve bëhet pa pagesë (taksa), ndërsa taksat tjera ende aplikohen (për ndryshime në biznes, shtim i aktiviteteve, ndërrimin e llogos etj.) Përcjellja e aktivitetit ekonomik të bizneseve, vizita e këtyre bizneseve, mbledhja e shënimeve për aktivitetin e tyre, ndihma e dhënë dhe informimi rreth regjistrimit dhe ndryshimeve në bizneset e tyre. Mbledhja dhe përpunimi i shënimeve dhe dërgimi i tyre në Ministrinë përkatëse, plotësimi i formularëve dhe pyetësorëve me shënimet e kërkuara. Gjithashtu janë punuar edhe shkresa të ndryshme zyrtare, si dhe përgjigje ndaj kërkesave të ndryshme të palëve drejtuar Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim gjegjësisht Sektorit për Ekonomi.

		Grante	THV	Totali	Gjendja
1	Hartimi i projekteve për infrastrukturë	40,000	20,000	60,000	Përfunduar

2	Mbikëqyrja e projekteve kapitale	15,000		15,000	Përfunduar
3	Ndërtimi i rrugës "Brahim Salihu" Tomoc-Kovragë	20,000	10,000	30,000	Përfunduar
4	Ndërtimi i rrugës "Hul Huli" Istog i Poshtëm	40,000		40,000	Përfunduar
5	Ndërtimi i rrugës lagja "Dekaj" në Istog të Poshtëm	20,000		20,000	Përfunduar
6	Ndërtimi i rrugës "Idriz Osmanaj" Trubuhovc	20,000		20,000	Përfunduar
7	Ndërtimi i rrugëve në Gurrakoc	60,000		60,000	Përfunduar
8	Ndërtimi i rrugëve në Banjë	60,000		60,000	Përfunduar
9	Ndërtimi i rrugëve në Vrellë	40,000		40,000	Përfunduar
10	Ndërtimi i rrugëve në Istog	80,000	60,000	140,000	Përfunduar
11	Ndërtimi i rrugëve në Kashicë	20,000	20,000	40,000	Përfunduar
12	Ndërtimi i rrugës në Lluga lagja "Meshi"	25,000	20,000	45,000	Përfunduar
13	Ndërtimi i rrugës lagja "Haskaj" Cerrcë	45,000		45,000	Përfunduar
14	Ndërtimi i rrugës Lubozhdë lagja "Idrizaj"		20,000	20,000	Në shqyrtim
15	Ndërtimi i rrugës në Kërrninë	20,000	15,000	35,000	Përfunduar
16	Asfaltimi i rrugës Istog-Cerrcë			23,214.38	Përfunduar
17	Asfaltimi i rrugës Bellopojë-Zhakovë			19,977.40	Përfunduar
18	Asfaltimi i rrugës në Gurrakoc lagja "Qukaj"			9,864.70	Përfunduar
19	Asfaltimi i rrugës Saradran - Ozdrim			40,211.80	Përfunduar
20	Asfaltimi i rrugës Shushicë dhe Uçë			77,742.53	Përfunduar

Sektori i zhvillimit

Tabela e projekteve kapitale të cilat janë në procedurë e sipër për periudhën Janar - Dhjetor 2019

VII. GJEODEZI DHE KADASTËR

Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër është e ndarë në dy sektorë dhe në kuadër të Drejtorisë ekziston edhe shërbimi pronëso-ro-juridik:

1. Sektori për Gjeodezi;
2. Sektori dhe Kadastër dhe
3. Shërbimi pronëso-ro-juridik

Sektori për Gjeodezi . Gjatë kësaj kohe të raportimit, në këta sektorë, zyrtarët janë ngarkuar në kryerjen e punëve sipas përshkrimit të vendeve të punës, ku detyrat kryesore janë, matjet gjeodezike në terren, ndarjen e ngastrave kadastrale, përkufizimin e ngastrave të ndryshme, dhënien e kopjeve të planit, llogaritjen e produkteve kadastrale për gjeodetët e licencuar, regjistrimin në regjistrat kadastral pjesën grafike dhe tekstuale, transaksione të ndryshme në terren, aktvendime për hipoteka, aktvendime të ndryshme në shërbimin pronëso-ro-juridik. Më poshtë kemi paraqitur të dhënat statistikore rreth kërkesave të parashtruara dhe lëndëve të kryera si në vijim: Kërkesa të parashtruara **11528** të natyrave të ndryshme. Trashëgimi **320** raste; Parcelim **402** raste; Transferim-kontrata **478** raste; Korrigjime **160** raste; Historiate **13** raste; Hipoteka **59** raste; Fshirje e hipotekës **40** raste; Certifikata të gjendjes ekonomike **2605**; Numri i certifikatave pronësore të lëshuara **6600**; Kërkesa për dalje zyrtare në terren **60**; Kërkesa për dalje private në terren **33**; Kërkesa të gjeodetëve të licencuar 203; Kërkesa për uzurpim të Pronës Publike **4**; kërkesa për uzurpim janë në procedim e sipër **4**; këmbim i pronës së paluajtshme të komunës me pronën private me qëllim të realizimit të interesit të përgjithshëm **18** raste;

Të dhëna e lartshënuara të paraqitura në mënyrë tabelore

Kërkesa të pranuar	Kërkesa të përfunduara	Kërkesa në procedurë
11528	10174	814
	Trashëgimi	320
	Parcelim	120
	Transferim-kontrata	478
	Korrigjime	160
	Historiate	13
	Hipoteka	59
	Fshirje e hipotekës	40
	Certifikata të gjendjes ekonomike	2605
	Certifikata pronësore	6600
	Dalje e gjeodetëve në terren sipas kërkesave zyrtare	60
	Dalje e gjeodetëve në terren sipas kërkesave private	33
	Kërkesa të gjeodetëve të licencuar	203
	Kërkesa për uzurpim të Pronës Publike	4
	Këmbim i pronës së paluajtshme	18

Ankand publik	1
Totali	10.714

Totali i të hyrave gjatë kësaj periudhe është 28,985.00 euro.

VIII. DREJTORIA PËR ARSIM

Drejtoria komunale e Arsimit, kryen detyrat dhe obligimet e veta në përputhje me Ligjin për Arsim parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032, Ligjin Për Arsim në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin Profesional Nr.02 L-42, Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin e të rriturve Nr. 02/L-24, Ligjin për Arsimin Parashkollor nga MASHT, Rregulloren Komunale për Punën e Institucioneve Arsimore Nr.41/2012 dhe UA të MASHT-it që përcaktojnë përgjegjësitë e Komunës për organizimin e procesit edukativo-arsimor në të gjitha nivelet.

Numri i institucioneve edukative-arsimore duke përfshirë edhe numrin e nxënësve në institucionet edukative dhe arsimore në Komunën e Istogut është:

- ❖ Pesë (5) kopshte - fëmijët një deri në nivelin para fillor;
- ❖ Njëmbëdhjetë (11) institucione - niveli para fillor, fillor dhe mesëm i ulët;
- ❖ Dy (2) institucione - niveli mesëm i lartë;

Numri i fëmijëve dhe nxënësve sipas niveleve në fillim të vitit shkollor në Komunën e Istogut është: në fillim të vitit shkollor 2017/18 është 7700 nxënës, në fillim të vitit shkollor 2018/19 është 7471 nxënës, në fillim të vitit shkollor 2019/20, 7150 nxënës. Në këtë vit shkollor numri i nxënësve është zvogëluar për 321 nxënës.

Numri sipas niveleve:

- ✓ Në kopshte në fillim të vitit shkollor 2017/18 ishte: 279 fëmijë;
- ✓ Në kopshte në fillim të vitit shkollor 2018/19 ishte: 275 fëmijë;
- ✓ Në kopshte në fillim të vitit shkollor 2019/20 ishte: 295 fëmijë;
- ✓ Në nivelin 1 deri në 5 vjeç në fillim të vitit shkollor 2017/18 në kopshte:184 fëmijë;
- ✓ Në nivelin 1 deri në 5 vjeç në fillim të vitit shkollor 2018/19 kopshte:227 fëmijë;
- ✓ Në nivelin 1 deri në 5 vjeç në fillim të vitit shkollor 2019/20 kopshte:232 fëmijë;
- ✓ Në nivelin para fillor 5-6 vjeç në fillim të vitit shkollor 2017/18 në kopshte:95 fëmijë;
- ✓ Në nivelin para fillor 5-6 vjeç në fillim të vitit shkollor 2018/19 në kopshte:48 fëmijë;
- ✓ Në nivelin para fillor 5-6 vjeç në fillim të vitit shkollor 2019/20 në kopshte:63 fëmijë;

- ✓ Në shkolla në fillim të vitit shkollor 2017/18-7421 nxënës;
 - ✓ Në shkolla në fillim të vitit shkollor 2018/19-7196 nxënës;
 - ✓ Në shkolla në fillim të vitit shkollor 2019/20-6855 nxënës;
-
- ✓ Në nivelin para fillor 5-6 vjeç në fillim të vitit shkollor 2017/18, në shkolla 441 fëmijë;
 - ✓ Në nivelin para fillor 5-6 vjeç në fillim të vitit shkollor 2018/19, në shkolla 428 fëmijë;
 - ✓ Në nivelin para fillor 5-6 vjeç në fillim të vitit shkollor 2018/19, në shkolla 379 fëmijë;
-
- ✓ Në nivelin 1-5 në fillim të vitit shkollor 2017/18, 2950 nxënës;
 - ✓ Në nivelin 1-5 në fillim të vitit shkollor 2018/19, 2914 nxënës;
 - ✓ Në nivelin 1-5 në fillim të vitit shkollor 2018/19, 2772 nxënës;
-
- ✓ Në nivelin 6-9 nxënës, në fillim të vitit shkollor 2017/18, 2449 nxënës;
 - ✓ Në nivelin 6-9 nxënës, në fillim të vitit shkollor 2018/18 është 2297 nxënës;
 - ✓ Në nivelin 6-9 nxënës, në fillim të vitit shkollor 2018/18 është 2232 nxënës;
-
- ✓ Në nivelin 10-12 në fillim vitit shkollor 2017/18, 1581 nxënës.
 - ✓ Në nivelin 10-12 në fillim vitit shkollor 2018/19, 1557 nxënës.
 - ✓ Në nivelin 10-12 në fillim vitit shkollor 2018/19, 1472 nxënës.

Drejtoria Komunale e Arsimit edhe këtë vit në bashkëpunim me drejtorët e shkollave, organizoi dhe monitoroi procesin mësimor i cili është organizuar në bazë të obligimeve që dalin nga politikat qendrore e lokale të bazuara në planet dhe strategjitë e aprovuara me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së shkollës në kontest të rritjes së cilësisë në arsim. Drejtoria Komunale e Arsimit në bashkëpunim me MASHT është e angazhuar në përmbylljen politikave të përmirësimit të infrastrukturës shkollore dhe në këtë funksion ka filluar ndërtimi i çerdhes së fëmijëve në Istog, ndërtimi i shkollës „Tre Dëshmorët e Shkollës Shqipe” në Uçë, ndërtimi i shkollës „Fan S. Noli” në Llukac të Begut ku komuna merr pjesë me rreth 700 000 euro si dhe ndërtimi i palestrës sportive në shkollën „Martin Camaj” në Gurrakoc. Organizimi i punës udhëhiqet dhe menaxhohet nga DKA-ja, drejtorët e shkollave dhe stafi profesional, prindër dhe nxënës, përmes organeve udhëheqëse të shkollës në bashkëpunim të vazhdueshëm me MASHT-in dhe Sektorin e Inspektoratit për Arsim. Është vlerësim i përgjithshëm se në aspektin organizativ dhe profesional, Arsimi i Komunës së Istogut vazhdon të jetë i organizuar dhe funksionon mbi bazën e standardeve të kërkuara nga MASHT dhe është në funksion të arritjes së standardeve të kërkuara e në disa raste është vlerësuar si model duke synuar trendet e nevojshme krahas zhvillimit të shoqërisë me tendencë të determinimit të nevojave shoqërore. **Gjatë kësaj periudhe të raportimit Drejtoria Komunale e Arsimit ka shpallur konkursin për afatin qershorit për regjistrim në shkollat e mesme të Larta në Komunën e Istogut i bazuar në kriteret dhe procedurat e regjistrimit të hartuara nga Ministria**

e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe është bërë regjistrimi i nxënësve në klasat e dhjeta dhe vazhdon regjistrimi në klasën e parë për vitin shkollor 2019/2020, bazuar në planifikimin për regjistrim. Numri i nxënësve të planifikuar për regjistrim sipas drejtimeve në vitin shkollor 2019/2020 është si ne vijim, në Gjimnazin „Haxhi Zeka” – numri nxënësve që është planifikuar të regjistrohen në drejtimin e shkencave natyrore është 224 dhe në afatin e parë janë regjistruar 122 ndërsa në drejtimin e shkencave shoqërore është 128 nxënës janë regjistruar 108. Në shkollën e Mesme Teknike „Mithat Frashëri” është planifikuar të regjistrohen në drejtimin makineri 140 nxënës, në drejtimin elektroteknikë 88 nxënës, në drejtimin ndërtimtari 28, në drejtimin ndërtimtari 28, në bujqësi 28 dhe në mjekësi 32 nxënës. Në shkollën e Mesme teknike “Mithat Frasheri” në paralelen e ndarë “Rudina” numri i nxënësve të planifikuar për regjistrim është 45.

Drejtoria Komunale e Arsimit ka monitoruar planet zhvillimore të shkollave, planet vjetore të drejtorëve të shkollave dhe ka mentoruar ato bazuar në politikat arsimore e po ashtu edhe planet mësimore të mësimdhënësve, duhet cekur se tani janë duke u shfrytëzuar edhe kapacitetet në kuadër të shkollave si koordinator të cilësisë, fasilitatorë – lehtësues, trajner të kurrikulës të procesit të implementimit të politikave arsimore qëndrore e lokale, në nivel të shkollës po nxitet bashkëpunimi profesional në kontest të rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe në të nxënë. Jemi në funksion të krijimit të rrjetit të komunikimit me qëllim të ndarjes së përvojave nga mësimdhënësit për zbatimin e kurrikulës dhe metodologjisë së mësimdhënies. Drejtoria Komunale e Arsimit në bashkëpunim me MASHT-in po zhvillon kapacitetet në kuadër të Institucioneve edukative dhe arsimore për vlerësimin e brendshëm të performancës së Institucioneve Edukative dhe Arsimore në të gjitha nivelet e Arsimit Parauniversitar të Komunës së Istogut dhe nga katër institucione arsimore që ishin në fillim të përzgjedhura për procesin e pilotimit në gjashtëmujorin e dytë të vitit të kaluar. Drejtoria Komunale e Arsimit ka organizuar zgjedhjen dhe funksionalizimin e ekipeve për vlerësimin e performancës së institucioneve arsimore në të gjitha institucionet edukative dhe arsimore. Në përbërje të ekipeve janë mësimdhënësit e niveleve të ndryshme brenda shkollës dhe drejtori i shkollës ndërsa koordinator i ekipit është njeri nga mësimdhënësit ose koordinatori i cilësisë së atij institucioni arsimor treguesit e pesë dimensioneve-fushave që ka për qëllim që institucionet vet të identifikojnë kahjet e zhvillimit të shkollës dhe në vlerësim përmes instrumenteve të përfshihen të gjithë aktoret e shkollës-institucionit edukativ e arsimor dhe të identifikohen e adresohen nevojat për një zhvillim cilësor të shkollës bazuar në kritere dhe treguesit e matshëm të fushave. Ky proces është duke ndodhur nga periudha e dytë e vlerësimit dhe zgjatë deri në përfundim të periudhës së tretë (kur i referohemi periudhës së dytë të vlerësimit, bëhet fjalë për muajin shkurt e cila zgjatë deri një javën e parë të prillit ndërsa periudha e tretë zgjatë nga muaji prill pas pushimit pranveror deri në muajin qershor kur edhe përfundon viti shkollor dhe këtë muaj presim që shkollat të dalin me raportet përfundimtare bazuar në vlerësimin e situatës –të gjeturat që dalin gjatë këtij procesi dhe këto raporte do të jenë impute të rëndësishme për vetë shkollat dhe për DKA-në. Rëndësi specifike këto raporte do të kenë gjatë analizës që do të ju bëhet të gjithë dokumenteve strategjike që parashikojnë zhvillimin e arsimit në Republikën e Kosovës e që do të krahasohen me gjendjen reale në Arsimin e Komunës së Istogut për të importuar dhe përshtatur si masa në kuadër të udhëheqjes dhe menaxhimit të Arsimit në Komunën e Istogut. Disa nga shkollat edhe kanë përfunduar raportet e vlerësimit e disa janë në proces të vlerësimit dhe përfundimit të raporteve.

Fushat mbi bazën e të cilave bëhet vlerësimi i brendshëm të performancës së shkollës janë:

- ❖ Menaxhimi dhe udhëheqja;
- ❖ Kultura dhe mjedisi shkollor;
- ❖ Mësimdhënia dhe të nxënit;
- ❖ Zhvillimi profesional i mësimdhënësve;
- ❖ Performanca e nxënësve.

Vlerësimi i performancës së brendshme të shkollës është i bazuar dhe ndihmon implementimin e strategjisë së re për sigurimin e cilësisë në Arsim- 2016 /2020 e cila është e bazuar në Planin Strategjik për Arsimin në Kosovë-2011-2016 dhe projektdokumente të tjera strategjike të MASHT-it dhe gjithsesi kjo strategji siguron qëndrueshmërinë e politikave në Arsim. Në funksion të realizimit të këtij procesi Drejtoria Komunale e Arsimit ka organizuar takime të vazhdueshme me ekipet për vlerësimin e brendshëm të shkollës dhe koordinatorët e ekipeve me qëllim të mbështetjes në aspektin profesional të procesit dhe implementimit të politikave shtetërore e komunale për forcimin e segmenteve të funksionimit të arsimit në Komunën e Istogut që si objektiva të realizueshme pas identifikimit të përparësive apo mangësive eventuale të përcaktohen masat që duhen të ndërmerren nga institucionet brenda komunës për përmirësimin e rezultateve dhe orientimin në zhvillimin normal të procesit. Drejtoria Komunale e Arsimit ka filluar me implementimin e strategjisë së re të MASHT-it e cila parasheh zhvillimin e Arsimit në Kosovë në periudhën 2016-2020 në këtë kuadër ne kemi marrë përgjegjësitë tona dhe jemi të gatshëm në realizimin me sukses duke shfrytëzuar kapacitetet në Arsimin e Komunës së Istogut. Në kuadër të nevojave për rritjen e cilësisë DKA-ja ka organizuar zgjedhjen e koordinatorëve të cilësisë në të gjitha shkollat e Komunës së Istogut të cilat në bashkëpunim me drejtorët e institucioneve edukative dhe arsimore do të sigurohen se procesi mësimdhënies dhe të nxënit sigurohet nga të gjitha fushat e lartpërmendura të zhvillimit standard përmes ciklit “Planifiko-Bëjë-Kontrollo-Vepro” ku hapi i parë është planifikimi përmes rishikimit të planeve zhvillimore në institucionet arsimore përmes një procesi gjithëpërfshirës në institucione që pikëmbështetëse e këtij rishikimi do të jenë të gjeturat nga procesi i vlerësimit të brendshëm të shkollës-institucioneve edukative e arsimore. Në këtë rast Drejtoria Komunale e Arsimit ka ndarë me Institucionet Arsimore bazën ligjore dhe profesionale si Udhëzime administrative, udhëzues të kornizës për sigurimin e cilësisë dhe vlerësimit të brendshëm të institucionit edukativ dhe arsimor dhe në bashkëpunim me Sektorin e Inspektoratit të arsimit në Pejë dhe MASHT-i ka organizuar takime konsultative me drejtorë dhe koordinatorë të cilësisë në funksion të implementimit të vlerësimit të performancës së mësimdhënësve, sigurimit të cilësisë ku pjesë e këtij angazhimi është edhe vlerësimi i brendshëm i institucioneve në gjitha nivelet e arsimit dhe edukimit përmes pesë fushave të lartcekura si dhe SIA ka filluar procesin e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve dhe fillimisht ka filluar me gjimnazin „Haxhi Zeka” ku janë përcaktuar dy mësimdhënës dhe në shkollën „Martin Camaj” në të cilën janë përcaktuar katër mësimdhënës për VPM dhe procesi po vazhdon me institucionet tjera sipas planifikimit të SIA-së në konsultim edhe me DKA-në, vlerësim DKA-së i shërben për t’i informuar me gjendjen reale nga vlerësimi i jashtëm.

Komuna e Istogut -Drejtoria Komunale e Arsimit është e orientuar në planifikimin permanent krahas zhvillimeve në politikat shtetërore duke involvuar zhvillime pozitive në implementimin e politikave përmes projekteve të ndryshme duke organizuar sesione informuese për konkurrim në projekte që kanë qëllim qasjen në donacione që krijojnë mundësi përfitimi në ngritjen e

kapaciteteve në infrastrukturë dhe ngritjen e kapaciteteve në mësimdhënie. DKA në bashkëpunim me institucione shëndetësore ka përfunduar projektin për kontrollimin ofmatologjik duke filluar me shkollat „Bajram Curri”, „Martin Camaj”, „Ndre Mjeda”, „Hysni Zajmi” dhe duke vazhduar me të gjitha institucionet edukative dhe arsimore të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët. Projekt tjetër që u realizua me sukses sëbashku me Drejtorinë e Shëndetësisë për edukimin e fëmijëve në aspektin shëndetësor ku janë të përfshirë nxënësit e klasës së parë dhe klasës përgatitore-parafillor duke sjellë informacione nga doktoresha Fahrije Gashi e cila ka dhënë udhëzime për higjienën orale (kujdesi për dhëmbët) dhe nxënësve ku janë dhuruar nga një pastë dhe brushë. Ky proces do të vazhdojë edhe në këtë vit shkollor dhe Drejtoria Komunale e Arsimit ka siguruar listat e nxënësve me të dhënat personale të nevojshme për nxënësit e ciklit parafillor dhe klasës së parë. Drejtoria Komunale e Arsimit në fillim të vitit shkollor 2014/15 ka përcaktuar tri shkolla për pilotimin KKK-së dhe KB-së zgjedhja e shkollave ka qenë e bazuar në kriteret e përcaktuara nga MASHT dhe tani në vitin 2019/20 është viti i katërt përkatësisht i pestë i implementimit të KKK-së dhe këtë vit pilotimi do të fillojë në klasat pasuese, klasat e niveleve dhe po vazhdohet me sukses implementimi i KKK-së në bashkëpunim me MASHT-SIA. Trajnerët, drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit, në fazën e parë të shkollave ishin përfshirë:

- ✓ Shkolla Fillore e Mesme e Ulët „Martin Camaj” ;
- ✓ Shkolla e Mesme e Lartë „Haxhi Zeka”;
- ✓ Shkolla e Mesme e Lartë „Mithat Frashëri”.

Në vitin shkollor 2017/2018 ka filluar implementimi KKK-së dhe KB-së në të gjitha shkollat e Komunës së Istogut duke përfshirë klasën përgatitore, klasat e para, klasët e dyta dhe pjesë e implementimit të Kornizës së Kurrikulës së re në vitin shkollor 2019/20 klasat e treta në nivelin fillor. Klasët e gjashta, klasët e shtata dhe këtë vit pjesë e implementimit të kornizës së kurrikulës së re në vitin shkollor 2019/20 do të jenë edhe klasët e teta në nivelin e mesëm të ultë dhe në funksion të implementimit sa me të suksesshëm të këtij procesi. DKA-ja është angazhuar në koordinimin e këtij procesi sipas strategjisë- planifikimit të MASHT-it për implementimin përmes fazave përgatitore që siguron realizimin e suksesshëm të objektivave të parapara. Drejtorët e shkollave duke qenë të përfshirë në trajnimin për menaxhim dhe udhëheqje module këto të bazuara në strategjinë e re janë edhe një siguri më e madhe se procesi do të jetë me lehtë i monitoruar dhe mentoruar dhe drejtorët e shkollave janë që janë përfshirë në procesin e trajnimit për implementimin e Kurrikulës së re të Kosovës në fushat të cilat janë ngritur profesionalisht si dhe duke planifikuar edhe takime periodike-konsulta profesionale nga DKA-ja përmes kapaciteteve të veta dhe kapaciteteve në nivel të shkollave si kapacitete të certifikuara profesionale për të garantuar procesin e implementimit të suksesshëm KKK-së. Mësimdhënësit e niveleve të lartcekura të cilët kanë filluar vitin shkollor 2017/2018 me implementimin e KKK-së edhe në këtë vit shkollor janë angazhuar në trajnime ata të cilët akoma nuk kanë përfunduar trajnimin dhe në vitin shkollor 2019/20 do të hyn në fazën e implementimit të KKK-së siç është cekur me lartë klasa e tretë dhe klasa e tetë. Ky proces zhvillohet me qëllim të lehtësimit të procesit të implementimit të KKK-së dhe KB-së dhe gjithsesi është duke u përkrahur komunikimi-bashkëpunimi ndërmjet mësimdhënësve të fushave dhe shkallëve kurikulare dhe kapaciteteve profesionale në nivel të komunës përmes takimeve të drejtpërdrejta dhe përmes rrjetëzimit elektronik me qëllim të informimit dhe shkëmbimit të informatave profesionale duke shfrytëzuar edhe përvojat e tri shkollave që janë përfshirë në fazën e parë të implementimit të

kurrikulës së re. Në fund të këtij viti Drejtoria Komunale e Arsimit ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me konsorciumin e kompanive "BASIC CHEK" e regjistruar në Zvicër dhe Agjencia për Zhvillim e Luksenburgut nëpërmjet Projektit KSV/015 do të mbështesë financiarisht Ofruesin e Shërbimeve për krijimin e sistemit për Informimin të Orientimit në karrierë dhe pjesë e këtij projekti janë të gjitha institucionet arsimore të Komunës së Istogut ku nxënësit do të përfitojnë përmes qasjes për këshillim në orientimin e tyre në karrierë dhe për tu konsultuar në orientimet e tyre arsimore bazuar në afinitetet e tyre dhe mundësit e tregut të punës brenda dhe jashtë vendit dhe me këtë rast kanë përfituar edhe mësimdhënësit në zhvillimin profesional. Drejtoria Komunale e Arsimit ka siguruar të gjitha të dhënat për mësimdhënësit e TIK-ut, koordinatorët e cilësisë së shkollave dhe informatat tjera që janë pjesë e bashkëpunimit për implementimin e projektit "busulla" në mbështetje për krijimin e kapaciteteve profesionale brenda shkollës ka përfunduar trajnimi për pesë hapat e orientimit në karrierë. Drejtoria Komunale e Arsimit në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës së Istogut z. Haki Rugova dhe Gjimnazin „Haxhi Zeka” i cili ka konkurruar me një projekt për të qenë pjesë e Programit të USAID-it "After School Support for Teens" (ASSET) – "Përkrahje adoleshentëve pas mësimi të rregullt". Është program 5-vjeçar që menaxhohet nga Qendra për Arsim të Kosovës (KEC) në partneritet me "FHI 360" dhe "Crimson Capital Corp". Qëllimi kryesor i Programit është zhvillimi i shkathtësive për punësim dhe ndërmarrësi tek të rinjtë duke krijuar botëkuptim pozitiv për të ardhmen e tyre. Motoja e Programit është "Përgatitja e të rinjve të Kosovës për jetë dhe punë në shekullin 21". Aktivitetet që do të realizohen nga ky program janë zhvillimi i kompetencave për jetë dhe punë, përkrahja e edukimit për karrierë dhe ndërmarrësi në shkolla. Tani Komuna e Istogut përkatësisht Gjimnazi „Haxhi Zeka” është pjesë e projektit që rezulton me nënshkrimi të memorandumit nga Drejtori i DKA-së Hajrush Shoshi dhe drejtori i Gjimnazit „Haxhi Zeka”. Këto nisma janë për të orientuar zhvillimin e kapaciteteve infrastrukturore dhe zhvillimin e kapaciteteve në mësimdhënie dhe në të nxënë janë pjesë e qasjes sonë për të siguruar praktika të domosdoshme dhe ekuivalente me praktikën përfundimtare që ndihmojnë edhe buxhetin e komunës përmes ofrimit të shërbimeve të nevojshme por që në raste të tilla sigurohet mbështetje financiare jashtë buxhetit të komunës. Implementimi i këtij projekti ka filluar me organizimin e Qendrës për Ndërmarrësi dhe Karrierë e cila është në proces të pajisjes me mjete të teknologjisë së paraparë arsimore. DKA-ja në bashkëpunim me shkollat ka organizuar gara të matematikës me qëllim të rritjes së cilësisë në arsim dhe nxënësit fitues. Tri vendet e para sipas klasëve janë simuluar me mirënjohje dhe pagesa modeste. Drejtoria Komunale e Arsimit ka përfunduar garat në nivel të shkollave dhe në nivel komunal ku janë përfshirë të gjitha shkollat e Komunës së Istogut. DKA në bashkëpunim me shkollat po realizon planin e veprimit i bazuar në analizën e situatës për përfshirje në arsim-parandalimin e braktisjes dhe mosregjistrimit të fëmijëve në shkolla bazuar në tri objektiva të planit:

Objektivat prioritarë të komunës:

1. Identifikimi dhe Integrimi i fëmijëve jashtë shkollës përmes identifikimit përmes bashkëpunimit të zyrave relevante të ekipeve shkollore për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të nxënësve në shkolla, komunitetit në afërsi të shkollës dhe prindërve.
2. Funkcionalizimi i ekipeve shkollore përmes krijimit të planeve të veprimit dhe menaxhimit të rasteve të identifikuar dhe raportimi – adresimi në institucionet përgjegjëse siç është DKA-ja.

3. Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuar përmes përmirësimit të ambientit shkollor, ambientit të mësimi dhe sigurimit të personelit adekuat dhe të mjaftueshëm.

Drejtoria Komunale e Arsimit ka mbajtur takime me donatorë të mundshëm që në angazhimet e tyre kanë çështjet e arsimit dhe në këtë funksion në kemi shprehur orientimet tona profesionale dhe institucionale për bashkëpunim dhe planifikim në planin trevjeçar duke vënë interesat tona komunale si prioritet të bashkëpunimit në sferën e gjithëpërfshirjes dhe në funksion të mbajtjes së qëndrueshmërisë në funksionalizimin e ekipeve komunale dhe shkollore që në fokus të obligimeve kanë gjithëpërfshirjen. Disa nga shkollat kanë siguruar përfitime të natyrës profesionale në mësimdhënie dhe në të nxënë por duke përfituar edhe në aspekt të rregullimit hapësirës fizike mësonjëtorëve.

Në katër shkolla të Komunës së Istogut janë zhvilluar aktivitete për të përkrahur mësimdhënësit dhe nxënësit në aktivitetet gjithëpërfshirëse në bashkëpunim në mes DKA-së dhe organizatave joqeveritare, përmes krijimit të qendrave mësimore në shkolla që përkrahin nxënësit në ngritjen e performancës së tyre akademike përmes organizimit të mësimi shtesë në mbështetjen e tyre në të nxënë dhe në aspektet tjera socioekonomike. Drejtoria Komunale e Arsimit ka analizuar nevojat dhe iu është përgjigjur kërkesave për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe kjo ka qenë kompetencë e ekipit komunal për vlerësim pedagogjik i cili iu është përgjigjur çdo kërkesë që është iniciuar duke vlerësuar dhe analizuar çështjet me rekomandime për kompetentet. DKA-ja në koordinim me MASHT-it ka bërë organizimin e testit të semimaturës. Testi final i semimaturës është mbajtur sipas kalendarit të MASHT. Testi është mbajtur në dy qendra dhe numri i nxënësve që ju nënshtruan testit të semimaturës është 578 semimaturant, mesatarja e arritshmërisë është 55,18 %. Testi i maturës është organizuar sipas planit të paraparë ku Drejtoria Komunale e Arsimit me kohë ka bërë të gjitha përgatitjet e parapara nga MASHT-ti dhe ka caktuar qendrat e testimit bazuar në numrin e nxënësve, administruesit dhe komisionet për mbikëqyrje. Qendrat për mbajtjen e testit të maturës janë organizuar në shkolla, në afatin e qershorit kanë qenë katër qendra dhe numri i nxënësve të përfshirë në këtë afat ishte rreth 498 maturantë. Në bazë të rezultateve të publikuara 359 maturantëve kanë rezultat pozitiv të shprehur në përqindje 72.09 %, ndërsa 139 kanë treguar rezultat negativ ose shprehur në përqindje 27.91 %. Në Gjimnazin “Haxhi Zeka” testit iu kanë nënshtruar 325 maturantë. Në bazë të publikimit të rezultateve nga komisioni i Maturës Shtetërore sukses pozitiv kanë treguar 298 maturantë shprehur në përqindje 92% , ndërsa 27 maturantë në test kanë rezultat negativ ose shprehur në përqindje 8.%, që iu nënshtruan testit. Kurse në Shkollën e Mesme Teknike „Mithat Frashëri” në Gurrakoc testit të maturës iu kanë nënshtruar 173 maturantë prej tyre 61 kanë treguar rezultat pozitiv shprehur në përqindje rreth 36% ndërsa 112 kanë treguar rezultat negativ apo 64% e maturantëve. Në afatin e dytë të maturës, testi është organizuar në një qendër- në shkollën „Mithat Frashëri” në Gurrakoc.

Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve Drejtoria Komunale e Arsimit ka vazhduar me organizimin i trajnimeve me qëllim të ngritjes së kapaciteteve në mësimdhënie dhe në të nxënë dhe udhëheqje arsimore. Ka vazhduar dhe funksionimi i Qëndres për Ngritje Profesionale gjithsesi është në këtë funksion. DKA-ja po bashkëpunon me MASHT dhe me shumë organizata që ofrojnë trajnime dhe ngritjen e kapaciteteve në Arsim si GIZ etj. Drejtoria e Arsimit gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore ka nxjerrë disa vendime të natyrave të ndryshme duke përfshirë vendime për pushim të lehonisë, vendime për pushime mjekësore, njoftime të ndryshme, rekomandime dhe kontrata për mësimdhënës të cilët janë pranuar sipas konkurseve të rregullta

duke përmbushur nevojat për staf profesional dhe teknik në institucionet edukative dhe arsimore.

Suksesi i nxënësve me nota **pozitive** në gjysmëvjetorin e dytë në vitin shkollor 2018/19 nga klasa e parë deri në klasën e dymbëdhjetë.

Klasa	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Gjithsej
M	270	270	299	284	302	257	262	228	270	213	135	243	3033
F	282	276	278	264	289	243	233	261	289	210	203	218	3046
Gjithsej	552	546	577	548	591	500	495	489	559	423	338	461	6079

Në këtë vit shkollor është organizuar edhe testi për shkallë që është pjesë e praktikave të vlerësimit sipas Kornizës së Kurrikulës së Kosovës dhe realizohet në fund të çdo shkalle kurrikulare. Ky proces është realizuar në bashkëpunim me MASHT dhe shkollat. Ministria e Arsimit ka hartuar testet për shkallë ndërsa Drejtoria Komunale e Arsimit ka shpërndarë testet në shkolla në versionin elektronik dhe ka monitoruar procesin të cilin e kanë implementuar drejtorët e shkollave në bashkëpunim me mësimdhënësit.

Drejtorja Komunale e Arsimit ka shqyrtuar kërkesa dhe lëndë të natyrave të ndryshme, janë harmonizuar kontratat e punës me aktet ligjore dhe normat e parapara, janë shpallur konkurse në harmoni me nevojat dhe kërkesat për kuadrin profesional dhe teknik si dhe konkursi për bursat komunale. Drejtoria Komunale e Arsimit gjithashtu ka bërë ndalesa në pagë për të sanksionuar moszbatimin me përpikëri të akteve dhe rregullave të parapara. Drejtoria Komunale e Arsimit ka organizuar garën e kreativitetit kulturor dhe garën e diturisë cila është zhvilluar në tri nivelet e konkurrimit, në nivel shkolle, nivel komunal dhe në nivel republikan, kjo ka qenë një sfidë për shkollat dhe Drejtorinë Komunale të Arsimit por me një organizim të të gjitha niveleve të komunikimit ky proces është përmbyllur me sukses.

A R S I M I – Planifikimi dhe shpenzimi i Buxhetit (I-VI / 2019) :

Planifikimi dhe shpenzimi i Buxhetit në Drejtorinë Komunale të Arsimit për periudhën Janar-Dhjetor 2019, i deklaruar në formën numerike dhe në përqindje të shpenzimit si vijon:

Planifikimi - 2019 **Shpenzimi /2019** **Shpenz.në %**

<u>Planifikimi - 2019</u>	<u>Shpenzimi /2019</u>	<u>Shpenz.në %</u>
* Buxheti për paga 3,881,664.00€	--- 3,834,000.00€	- - - 98.77 %
* Mallra e shërbime.... . 335,220.00€	--- 314,320.00€	- - - 93.77 %
* Komunale..... 33,000.00€	--- 32,940.00 €	- - - 99.82 %
* Subvencione..... 43,750.00€	--- 29,810€	- - - 68.14 %

* Kapitalët..... 295,500.00€ - - -

*Të hyrat vetanake... 76,220.00€ - - - 74,260.00€ - - - 97.43 %

Infrastruktura në institucionet edukative e arsimore Janar-Dhjetor- 2018, qëllimi:

Paraqitja e raportit të punës së realizuar (projektet) në Drejtorinë Komunale të Arsimit për periudhën Janar-Qershor 2019. Gjatë kësaj periudhe kohore, me kërkesat e drejtorëve të Institucioneve Shkollore dhe përcjelljet e këtyre kërkesave si dhe angazhimin e Sektorit të Arsimit, janë realizuar projekte të ndryshme nga Lista e Projekteve kapitale dhe të tjera (tabelari i mëposhtëm). Është kryer regjistrimi i inventarit për vitin 2018 në të gjitha institucionet shkollore. Janë bërë pajisjet dhe furnizimet me material sipas nevojave që kanë parashtruar drejtorët me kërkesat e këtyre institucioneve, janë kryer pagesa të ndryshme , furnizime dhe pajisje, mbajtja e testit të Semimaturës-2019, mbajtja e testit të Maturës-2019, rregullimi i transportit të administruësve të Testit të Maturës 2019 etj.

Drejtoria Komunale për Arsim, duke u bazuar në listën e projekteve të vitit 2019,gjatë kësaj periudhe i ka realizuar projektet si në vijim :

Nr	Kodi prog.	Përshkrimi i Kontratës	Vlera e parashikuar	Implementimet
1	48922	Instalimi I kamerave ne kf. "G.Ynë"+"A.Jonë"+"P.Ardhmërisë"	3,273.65	Është implementuar
2	48929	Ndërtimi i depos për dru"L.Jetës"Vrellë	3,325.00	Është implementuar
3	48927	Renovimi i nyjeve sanitarekf."A.Jonë"+"P.Ardhmërisë"	7,157.00	Është implementuar
4	48964	Renovimi i kulmit"L.Jetes"	5,531.00	Është implementuar
5		Pajisja me inventarë kop.f. „G.Ynë”- Istog	12,680.00	Është implementuar
6		Dezinfektim,dezinfektim,deratizim i IEAP	2,000.00	Është implementuar
7	48978	Instalimi i kamerave ne Shkollën "B.Curri"obj.I+II	3,687.00	Është implementuar
8	48966	Renovimi I obj.shk."B.Curri"Muzhevinë dhe hapja e pusit	15,599.00	Është implementuar
9	48968	Renovimi i obj.shk."B.Curri"Dubravë dhe hapja e pusit	13,790.70	Është implementuar
10	49071	Renovimi i kulmit"M.Camaj"Gurrakoc	2,954.00	Është implementuar
11	48973	Renovimi i kulmit të obj.shk."H.Zajmi"Vrellë	3,291.00	Është implementuar
12	48989	Ndërtimi i depos së druve "Trepça"Banjë	5,232.00	Është implementuar

13	49010	Renovimi i sallave sportive në Istog dhe Saradran	40,000.00	Është implementuar
14	48976	Renovimi i nyjeve sanitare "Trepça"-Banjë	2,408.50	Është implementuar
15	48993	Pajisja e bibliotekës / inventar+ lektyra "Z.Zeka"	2,000.00	Është implementuar
16	49005	Pajisja e bibliotekës me lektyra "H.Zajmi" Vrellë	3,000.00	Është implementuar
17	48965	Ndërtimi i objektit të ri shk. "F.S.Noli" - Ll.Begut	70,000.00	Në implementim
18		Pajisja me mjete TIK- "Z.Zeka" -Kaliqan	7,691.00	E Implementuar
19		Renovimi i depos & Kalldas shf. "B.Curri" -Cerrcë	12,818.00	E implementuar
20		Rregullimi i infrastrukturës-Shk.Trepça-Banjë	14,200.00	E Implementuar
21		Pajisja me uniforma shkollore	600.00	E implementuar
22		Ndërtimi i Lapidarit Zymer Zeka në Kaliqan	950.00	E implementuar
23		Pajisja me tabela magnetike/ Institucionet shk.	4,690.00	E implementuar
24	49018	Pajisja e bibliotekës në Gjinnazin "H.Zeka"	5,000.00	Është implementuar
25	49015	Rregullimi i infrastrukturës së jashtme në Gjinnazin "Haxhi Zeka" Istog	14,269.00	Është implementuar
26	49012	Pajisja e punëtorisë së makinerisë me mjete përkatëse- "M.Frashëri" -Gurrakoc	34,990.00	Është implementuar
27		Renovimi i nyjeve sanitare "Haxhi Zeka", Istog	21,000.00	E implementuar
28		Servisimi i ngrohjeve qendrore/institucionet shk	9,500.00	E Implementuar
29		Furnizimi me lëndë djegëse/ dru	57,112.00	Implementohet
30		Transporti i nxënësve për në shkollë- 2019/21	26,800.00	Implementohet Dy vjeçar

IX. DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Drejtoria për Kulture, Rini dhe Sporti gjatë këtij viti ka realizuar disa projekte ne infrastrukturë po ashtu ka zhvilluar një varg aktivitete kulturore dhe sportive. Këto aktivitete janë organizuar në nivele të shkollave, nivel lokal dhe në nivelin komunal e shtetëror në të gjitha degët e sportit. Projektet e realizuara në infrastrukturë. Projekti " Mirëmbajtja e stadiumit të futbollit " në Istog. Furnizimi me karrika (ulëse) në stadiumin e futbollit . Ndërtimi i fushës së tenisit në Istog. Furnizimi me libra në bibliotekën e qytetit. Renovimi i zyrave dhe sallës së vallëzimit në shtëpinë e Kulturës në Istog. Botimi i librit me poezi për nxënës të shkollave. Dekorimi i katalogut me punime artistike. Dekorimi i qytetit me drita dekorative.

Në Sektorin e Kulturës janë realizuar këto aktivitete :

Për nder të Ditës së Pavarësisë së Kosovës është realizuar një program kulturor- artistik më këngë dhe valle dhe është bërë hapja e ekspozitës arkeologjike në shtëpinë e Kulturës në Istog. Ne bashkëpunim me OJQ-në "Folklori i Podgurit " është organizuar festivali i fëmijëve, me nxënës të shkollave është bërë hapja e ekspozitës artistike në shtëpinë e Kulturës në Istog. Për nder të Ditës së Çlirimit të Komune së Istogut janë zhvilluar shume aktivitete kulturore. Pjesëmarrja e SHKA në 5 festivale brenda dhe jashtë territorit të Kosovës. Në bashkëpunim me OJQ-në "Folklori i Podgurit " është organizuar festivali "Gurra e Folklorit shqiptarë". Ne bashkëpunim me OJQ-në "Podguri " është organizuar ora letrare "Çmimi Dr Ibrahim Rugova " në të cilën kanë marrë pjesë poetë nga Kosova, Shqipëria dhe Italia. Për nder të Ditës Ndërkombëtarë të Fëmijëve është organizuar program kulturor-artistik. Me rastin e festave të fundvitit në shtëpinë e Kulturës janë organizuar aktivitete për fëmije. **Nga Sektori i Rinisë dhe Sportit janë realizuar këto projekte - aktivitete.** Në bashkëpunim me Klubin e Shahut "Istogu" është organizuar Turniri Tradicional në shah kushtuar " Tre dëshmorëve të shkollës shqipe". Në këtë turnir morën pjesë shahistët më të mirë kosovarë, vlen të veçohet se këtë vit turniri ishte ndërkombëtarë. Organizimi i punëtorisë tre ditore me të rinjtë istogas me temën " Sporti për të gjithë". Organizimi i trajnimeve për rini me temën " Përgatitja e rinisë për tregun e punës" . Implementimi i projektit "Procesi i liberalizimit të vizave, të drejtat dhe detyrimet". Organizimi i trajnimeve " Rinia në vendimmarrje për politika rinore". Organizimi i takimeve rinore në bashkëpunim me USAID-in me temën " Hartimi i Planit të KVRL-së ". Organizimi i sallonit me temën " Sa kanë hapësirë të rinjtë e Istogut për zhvillimin e aktiviteteve rinore ". Organizimi i punëtorisë me temën "Të rinjtë punëkërkues në sektorin e shtypshkronjave dhe mobilierisë". Për nder të Ditës Olimpike janë organizuar gara në vrapim për nxënës të shkollave, është organizuar " Krosi Pranveror " në kuadër të shkollave fillore dhe të mesme. Për nder të dëshmorit "Demush Mavraj" është organizuar turnir në futboll të madh. Në bashkëpunim me OJQ-në "Sporti Shkollorë" janë organizuar gara në futboll , hendboll, basketboll dhe ping-pong. Në këto gara kanë marrë pjesë ekipet e përzgjedhura nga të gjitha shkollat e Komunës së Istogut. Kampion në futboll u shpall Sh.f.m.u."Bajram Curri" Istog kurse për hendboll Sh.f.m.u."Trepça" Banjë. Garat në futboll dhe hendboll janë mbajtur edhe në kuadër të shkollave të mesme ku vendi i parë në futboll i takoi Sh. M. T. "Mithat Frashëri" nga Gurrakoci kurse në hendboll i takoi Gjimnazit "Haxhi Zeka". Garat sportive janë zhvilluar edhe në ping-pong për shkolla fillore, ku vendin e parë e zuri Sh.F.M.U."Hysni Zajmi" nga Vrella. Në bashkëpunim me federatën e sportit shkollor janë mbajtur gara edhe në basketboll dhe volejboll si për shkolla fillore ashtu edhe për shkolla të mesme. Në shkolla fillore vendi i parë për basketboll i takoi

Sh.F.M.U."Bajram Curri " nga Istogu kurse për shkolla të mesme Gjmnazit "Haxhi Zeka". Për vajza vendi i parë i takoi Sh.M.U."Ismail Qemaili" nga Saradrani kurse në volejboll në kuadër të shkollave fillore vendi i parë i takoi Sh.F.M.U."Ismail Qemaili" nga Saradrani. Për shkolla të mesme Gjmnazi "Haxhi Zeka" Istog. Në bashkëpunim me OJQ-të rinore që veprojnë në Komunën e Istogut është themeluar Kuvendi KVRL dhe organet e kësaj organizate. Janë organizuar garat regjionale në futboll, hendboll, basketboll, volejboll dhe ping-pong. Në gara regjionale kanë marrë pjese : në hendboll vendi i parë i takoi Sh.F.M.U "Trepça" po ashtu edhe në nivel të garave republikane kurse për shkolla të mesme Gjmnazit "Haxhi Zeka"i takoi vendi i parë në garat regjionale kurse në garat republikane mori vendin e dytë . Në basketboll: Sh.F.M.U. "Bajram Curri" vendi i parë në garat regjionale kurse në garat republikane zuri vendin e dytë. Në volejboll: Sh.F.M.U. "Ismail Qemaili" Saradran dhe Gjmnazi "Haxhi Zeka" Istog. Në ping-pong : Sh.M.T. "Mithat Frashëri" nga Gurrakoci vendi i parë në garat regjionale po ashtu edhe në ato republikane kurse në konkurrencën e vajzave Gjmnazi "Haxhi Zeka" vendi i parë në garat regjionale kurse vendi i dytë në garat republikane. Për organizimin e këtyre garave Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka mbuluar të gjitha shpenzimet në transport si dhe për shpërblime tjera: kupa, dresa dhe medalje. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport përveç këtyre aktiviteteve ka përkrahur klubet sportive që janë të licencuara në federatën përkatëse me mjete materiale, në bazë të buxhetit që posedon janë përkrahur klubet sportive. Me angazhimin e përbashkët me udhëheqësit e klubeve janë zhvilluar shumë aktivitete dhe janë arritur shumë rezultate të klubeve si : klubi i hendbollit "Istogu" i cili është shpallur Kampion i Kosovës njëherit edhe fitues i Kupës së Kosovës në hendboll për vajza. Janë organizuar aktivitete sportive " Lojërat popullore në bjeshkët e Istogut" aktivitet ky i organizuar në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë. Në bashkëpunim me Komitetin Olimpik të Kosovës është organizuar "Panairi i Sportit" aktivitet që mbahet për herë të parë në Komunën e Istogut i cili kishte për qëllim promovimin e sportit dhe klubeve sportive. Është organizuar turniri ndërkombëtarë në karate "Adem Jashari" në të cilin kanë marrë pjesë shumë ekipe jashtë Kosovës.

X. DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE HIDROEKONOMI

Punët dhe aktivitetet e zhvilluara pranë Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi për periudhën Janar- Dhjetor 2019 janë zhvilluar në bazë të programit të punës dhe kërkesave të parashtruara në Drejtori si nga qytetarët dhe fermerët në lëmin e prodhimit të bujqësore, blegtorale si dhe vlerësim të dëmeve në sektorin e blegtorisë dhe kulturave bujqësore. Këtë vit Drejtoria për Bujqësi ,Pylltari dhe Hidroekonomi i ka kryer të gjitha procedurat për fermerët: plotësimin e aplikacioneve, dhënie të këshillave dhe dorëzimin e tyre në MBPZHR në mënyrë që këta fermerë të jenë përfitues të mundshëm të subvencioneve nga MBPZHR nga lëmia e blegtorisë (lopë qumështore, dele dhe dhi), perimekulturës, pemëtarisë, shpeztarisë dhe lavërtarisë (grurë, misër dhe tërshërë etj.). Bazuar në nenin 13, pika b të Ligjit për Vetqeverisje Lokale 03/L 040 dhe sipas kërkesave të fermerëve është bërë kompensimi i dëmeve në blegtori, kultura lavërtare dhe objekte bujqësore.

Deri me 30.06.2019 përmes Drejtorisë për bujqësi për subvencione kane aplikuar:

Numri i aplikuesve per Pagesa Direkte (Subvencione) për Komunën e Istogut, për vitin 2019

Nr.rendor	Emri i projektit	Nr. i aplikuesve	Njësia	Vlera/€
1	Pagesa Direkte-Grurë , miser,perime, pemëtari dhe farë gruri	560		
2	Pagesa Direkte-Lopë ,dele, dhi , bletë dhe qumësht	435		
	TOTALI	995		

Është hartuar plani i mbjelljeve pranverore, vjeshtore dhe realizimi i këtyre mbjelljeve të kulturave pranverore dhe vjeshtore. Gjithashtu janë lëshuar vërtetime fermerëve që merren me veprimtari bujqësore qoftë me veprimtari blegtorale, lavërtari , perimekulturë, pemëtari dhe veprimtari tjera bujqësore.Është formuar shtabi për korrije-shirje i përbërë nga ekspertët e kësaj veprimtarie, është bërë përcjellja e fushatës së korrije-shirjeve deri në përfundim. Gjatë kësaj periudhe nga ana e drejtorisë janë përfunduar këto projekte:

PROJEKTET E DREJTORISË PËR BUJQËSI 2019

Nr.	Emri i Projektit	Shuma	
1	Mirëmbajtja e rrugëve malore	50.000	
2.	Betonimi i Kanalit te ujitjes Vrelle-Prigode	60.000	
3	Rregullimi i Pronave Komunale. Projekt dy vjeçar 2018-2019	74.500	
4.	Betonimi i kanalit të ujitjes në Tomoc	40.000	
5.	Pastrimi i i kanaleve të ujitjes	20.000	
6	Ndërtimi i sistemit të ujësjellësit Kodra e Dynes-Lugu i Butë	30.000	
7	Hapja e rrugës malore Studenicë-Lugu i Mëhallës	36.750	
8.	Betonimi i Kanalit të ujitjes Kashicë- Saradran, MMPH dhe Komuna 2019-2020	100.000 Për vitin 2019	Për vitin 2020 200.000 Kontrata e nënshkruar (218.718,86 €)
9.	Ngritja e serave 240 m ² nga kodi i Subvencioneve dhe transfereve me participim	46.820	
	Gjithsejtë:	458.070,00 €	

SEKTORI I PYLLTARISË

Po paraqesim shënimet në formë tabelare realizimin e punëve deri ne muajin dhjetor për vitin 2019.

Tabela nr.1 Të dhënat mbi fletëparaqitjet.

Nr. i Fletëparaqitjeve copë	Penale		Kundërvajtje		Te realizuara	
	copë	M³	copë	M³	Penale	kundërvajtje
100	52	371.57	48	92.28	00	00

Tabela nr.2. Realizimi nga shitja me tender.

Nr. i kontratës Nr.633/19/059 Nr.633/19/059	Lloji i drurit	Çmimi		Te realizuara	
		Tek.	Zjarri	Tek m³	Zjarri m³
Kontrate				00	3023.44
Me vendim				14.87	1175.90
	Gjithsejtë:	00		14.87	4199.34

Tabela nr. 3. Masa e konfiskuar nga janari deri më 30 .11. 2019.

Të konfiskuara	
Teknik m³	Dru zjarri m³
65.82	43.18

Tabela nr. 4. Kërkesat e pyjeve private

Kërkesa të pranuar për shqyrtim nga pyjet private	Të realizuara	Damkosja e trungjeve		Gjithsejtë të damkosura	Flete. Percj. E dhëna	Masa e percjellë M³
		Tek.	Zjarri			
146	72				152	2340.50

Tabela nr. 5. Të hyrat nga pyjet private dhe ato publike nga janari deri më 30.11.2019

Të hyrat nga pyjet private €	Të hyrat nga pyjet publike në kontrata €	Gjithsejtë
6.378,82	61.186,00	67.564,82

XI. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Shëndetësia paraqet një segment të rëndësishëm për komunën dhe si e tillë gjatë kësaj periudhe e tërë puna dhe veprimtaria e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ka qenë e drejtuar në përmirësimin dhe në ngritjen e cilësisë dhe disiplinës në kryerjen e shërbimeve shëndetësore për qytetarët e Komunës së Istogut. Rëndësi të veçantë iu është kushtuar sidomos zbatimit të reformave në lëminë e mjekësisë familjare, përmirësimit të kushteve të punës dhe të infrastrukturës në objektet shëndetësore. **Plani i punës** - Gjatë kësaj periudhe fillimisht është bërë Plani i Punës për vitin 2019, në të cilin janë përcaktuar detyrat dhe objektivat të cilat kjo drejtori ka planifikuar t'i realizojë gjatë kësaj periudhe. Është bërë plani i shpenzimeve të fondeve të alokuara në katër nënprograme buxhetore të cilat i menaxhon Drejtoria për Shëndetësi (administrata shëndetësi-(73026), Shërbimet e Shëndetit Primar-(74000), Shërbimet Sociale-(75581) dhe Shërbimet Rezidenciale- (75582). Sa i përket realizimit të shpenzimeve mund të themi se shpenzimi i fondeve në të gjitha kategoritë ekonomike ka shkuar sipas planit dhe të gjitha kërkesat të cilat kanë ardhur nga njësitë buxhetore, janë përmbushur. **Shqyrtimi i kërkesave**- Gjatë kësaj periudhe në këtë drejtori janë parashtruar një numër i madh i kërkesave të cilat kanë të bëjnë me kërkesat për ndihmë finaciare për shërim dhe blerje të medikamenteve për këtë qëllim janë ndarë **30,950.00 €** dhe kanë përfituar 220 individë, pastaj kemi pasur edhe një numër të madh të kërkesave për kompenzimin e shpenzimeve të karburantëve për personat të cilët janë në Hemo-dializë dhe kanë nevojë për përcjellës dhe si mjete transporti përdorin automjetet private, pastaj personat të cilët kanë qenë në rrezatim në QKUK. Për grupin e parë kemi ndarë nga 57 lit. karburant në muaj ndërsa për grupin e dytë nga 10 lit. karburant për një relacion Istog-Prishtinë dhe anasjelltas. Për këto dy qëllime deri më tani janë dhënë **12182 lit.** karburantë.

Realizimi i Projekteve - Sa i përket projekteve në këtë vit kemi planifikuar realizimin e këtyre projekteve:

1. Blerja e paisjeve Mjekësore;
2. Blerja dhe Montimi i ashensorit në Objektin e QKMF;
3. Mirëmbajtja e Objekteve Shëndetësore dhe Sociale;
4. Digjitalizimi i Sistemit Shëndetësorë;
5. Blerja dhe Montimi i Kalldos në QKMF dhe
6. Ndërtimi i Depos në Shtëpinë për Komunitete në Gjurakoc, faza e dytë.

Të gjitha këto projekte janë realizuar sipas planit vjetor të punës. Projekti **Digjitalizimi i Sistemit Shëndetësorë** në shumën prej 25,000.00€, është realizuar nga Ministria e Shëndetësisë përmes

fondit të Huamarrjes nga Banka Botërore në vlerë prej 94,294.00€. Ndërsa mjetet e planifikuara për këtë projekt, me kërkesë të drejtorisë dhe me aprovim të Kuvendit Komunal, janë ridestinuuar për projektin **“Blerja dhe Montimi i Kalldos në Objektin Nr.1 të QKMF”** dhe i njëjti është realizuar në këtë vit kemi vazhduar me projektin me bashkëfinancim të Komunës së Istogut dhe Caritas Kosova me titull **“ Përkujdesja Shëndetësore Shtëpiake dhe Ambulator – Home Care 2019”** i cili realizohet me vizita sistematike në shtëpi për personat dhe familjet me nevojë. Implementues i këtij projekti është Caritas Kosova dhe zgjatë nga 01.01.2019 deri me 31.12.2019. Vlera e këtij projekti është **110,000.00€**. Caritas Kosova, do të participojë në këtë projekt me pajisje, infrastrukturë menaxhuese, pajisje shëndetësore në vlerë prej **18,000.00 €**, Komuna e Istogut do të participojë në vlerë monetare shumë prej **92,000.00€ dhe** përmes këtij projekti kemi realizuar punësimin e 20 punëtorëve kryesisht staf shëndetësorë.

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE -ISTOG

Vizita mjekësore: Në Q.K.M.F , Q.M.F dhe AMF gjithsejtë janë kryer 77603 vizita mjekësore, përfshirë shërbimet laboratorike, rtg, stomatologji. **Numri i shërbimeve.** Infermierore duke përfshirë dhënia e terapisë paranterale , lidhje pastrim plage etj gjithsejtë janë 391417.

Numri i vizitave shtëpiake. Nga ekipe mjekësore- mjek, infermier si dhënia e terapisë intravenoze ,vendosja e kateterit si dhe shërbime tjera janë kryer 810 shërbime.

Furnizimi me terapi. Gjatë këtij viti - 2019 në periudhen Janar - Nëntor janë realizuar gjithsejt 11 porosi të rregullta nga LE për barna dhe material shpenzues nga MSH , ka mbetur edhe mundësia e realizimit të porosisë së 12 që do të thotë të realizohen të gjitha porositë e rregullta sipas planifikimit për këtë vit. Furnizimi në gjashtë mujorin e parë sa i perket barnave orale dhe parenterale ka qenë i kënaqshëm përveç disa mungesave të vogla nga materiali shpenzues. Ndërsa në gjashtë mujorin e dytë furnizimi ka rënë dukshëm ka pasur mungesa të shumta duke u nisur nga barnat orale, parenterale e deri të materiali shpenzues (shiringa ,gjilpëra etj.). Mungesa e barnave nga lista esenciale është kompenzuar nga buxheti i komunës duke shpenzuar rreth 50,000.00€. Po ashtu gjatë tërë vitit nuk jemi furnizuar fare me filma për rentgen dhe kjo mungesë është mbuluar nga buxheti i komunës. Ndërsa furnizimi me insulina gjatë tërë vitit ka qenë i rregullt përveç insulinës “ Levemir” që ka pasur mungesë në dy muajt e fundit.

Vizita mjekësore nga SH.Mendor. Ekipi i Shëndetit Mendor -Pejë mjek -infermier kanë kryer vizita mjekësore për 345 klientë si dhe trajtimi me terapi muskulare si me moditen depo 84 amp dhe amp Haldol depo 163 amp. Të gjitha ampulat të blera nga Komuna .**Vazhdimi me planprogramin e ZHVP-së për infermierë:** janë prezantuar 12 ligjërata me tema të ndryshme sipas planit në QKMF Istog .

Trajnimet. Trajnimi 4 ditor në Regjion Pejë, Plani i Veprimit për Kujdesin Parësor Shëndetësor në lidhje me identifikimin e nevojave të pajisjeve mjekësore, renovime, trajnime etj. AQH – MSH si dhe Trajnimi i mbajtur më 27.02.2019 në Istog nga Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë PRAK nga Prishtina, pjesëmarrës 10 mjekë dhe 25 infermierë. Trajnime gjatë muajit qershor ku dhe qendra jonë përfshinë programin për Vizitat në shtëpi -Kujdesi për shëndetin e nënës dhe fëmijut. Nga qendra jonë janë trajnuar 4 grupe, një mjek dhe 5 infermierë. Më 09.10.2019 trajnim në QKMF- Gjakovë rreth përvojave të vizitave në shtëpi (për shëndetin e

nënës dhe fëmiut). Më 14.10.2019 trajnim 5 ditor në Qendrën e Trajnimit në Pejë, i përbërë prej 5 moduleve, tri grupe nga 5 pjesëmarrës, mjek, infermier nga qendra jonë. Më 28.10.2019 prezantimi i ligjeratës për vetëdijsimin kundër kancerit të gjirit (në Restuarant "Freskia" me gra dhe vajza të Komunës së Istogut ligjërues Dr.Çelë Alijaj dhe trajnere Sevdije Shabanaj. Me 31.10.2019 prezantim i ligjeratës "Vetëdijsimin kundër kancerit të gjirit në fshatin Serbobran, gra dhe vajza të komunitetit, ligjërues Sevdije Shabanaj. Më 26.11.2019 IKSH e Kosovës organizon punëtorinë "Programi i Zgjeruar i Imunizimit, Sfidat dhe arritjet ". Pjesëmarrës epidemiologia dr.Lumturije Sadikaj si dhe Kryeinfermierja Sevdije Shabanaj. Më 04.09.2019 takim pune me Z.Nexhmije Huli, Ndërmjetsuese sociale dhe shëndetësore bashkëpunim me " Vizionin 02" me kërkesën për mbështetje nga shëndetësia sipas nevojave për aktivitetet në fshatrat për komunitet lidhur me edukimin shëndetësor si dhe për nevoja tjera. Më 10.09.2019 mbajtja e trajnimit 2 ditor me temën "Shëndeti Seksual Reproductiv në raste krizave ", pjesëmarrës mjek- infermiere gjithsejtë 18 QKMF Istog Më 17.09.2019 takim pune në Prishtinë me temën "Konfirmimi ,hulumtimi dhe menaxhimi i rasteve dhe epidemia e fruthit në Kosovë". Pjesëmarrës epidemiologia dhe kryeinfermierja. Më 18.09.2019 lansimi i programit për vizita në shtëpi me pjesëmarrës dr.Albana Morina, Udhëheqëse e kujdesit Parësor Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë. **Donacione.** Më 11.10.2019, nga donatori z.Xhafer Balaj ka sjellë një donacion me shtretër, dyshekë dhe disa sirtarë për nevoja QKMF-së .

Vaksinimi. Në shërbimin e vaksinimit janë dhënë 11879 vaksina dhe janë kryer rreth 22572 shërbime.Plani deri në muajin nëntor është realizuar me **94.72 %**.

Vaksinat e gripit sezonal, janë marrë 3000 doza nga IKSH ndërsa janë aplikuar deri me tani 2200 doza. **Hemodializa.** Transporti i pacientëve për Hemodializë në Spialin Rajonal –Pejë është bërë 3 herë në javë. Numri i pacientëve që janë transportuar për nevoja të hemodializës gjatë kësaj periudhe ka qenë 13.

Maternitet dhe gjinekologji:

- Gjatë kësaj periudhë në Maternitetin e Q.K.M.F –Istog janë kryer 35 lindje;
- Vizita për nëna dhe fëmijë në shtëpi janë kryer 69 vizita dhe
- Vizita gjinekologjike kane kryer 1799 pacient.

Kujdesi Shtëpiak –Caritas Kosova:

Kujdesi në shtëpi është përcaktuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë si "aftësia për të ofruar në shtëpinë e pacientit ato shërbime dhe mjete që kontribuojnë në ruajtjen e nivelit më të lartë të mirëqenies, shëndetit dhe funksionit jetik. Shërbimi Mjekësor në Shtëpi është një grup i koordinuar i veprimtarisë shëndetësore, me ndërhyrjet e duhura drejtuar mirëqenies sociale, shëndetit, rehabilitimit dhe për të ndihmuar personin e sëmurë në shtëpi. Synimi kryesor i këtij projekti është duke u bazuar në modelet e përvojat me të suksesshme të kujdesit në shtëpi kujdes që lejon përfituesin të qëndrojë në shtëpi dhe të përfitojë nga marrja e shërbimeve "Home Care" Istog ka pasur mbështetje të vazhdueshme nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, janë siguruar vizitat në terren nga mjekët, është bërë sigurimi i autoambulancës për përfituesit e projektit, është bërë sigurimi i medikamenteve esenciale nga barnatoria qendrore e Q.K.M.F-së Istog, sigurimi i gazave, instrumenteve sterile, sigurimi i katetrave, qeseve për stomë etj.

Periudha kohore Janar –Dhjetor 2019 janë kryer gjithsej 1159 vizita shtëpiake

SHËRBIMET SOCIALE. Aktiviteti i këtij shërbimi bazohet në Ligjin për Skemën e Ndhimave Sociale në Kosovë Nr.2003/15, Rregullores Zbatuese Nr.2003/XX mbi Zbatimin e Ligjit dhe Udhëzimit Administrativ Nr.06/2005 për Rregullimin e Procedurave të Përkrahjes si dhe Ligjin Nr.04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 2003/15 të Skemës së Ndhimës Sociale në Kosovë. Gjatë periudhës vjetore 2019 në këtë shërbim mesatarja e shfrytëzuesve të ndihmave sociale është 423 familje me 1801 anëtarë, mesatarja në kategorinë e parë 208 familje me 751 anëtarë dhe mesatarja në kategorinë e dytë 215 familje me 1050 anëtarë.

Aplikacionet e reja. Gjatë periudhës raportuese numri i aplikacioneve të reja ka qenë 102 aplikacione; 75 aplikacione të kateg. së II-të dhe 27 të kateg.së parë dhe prej tyre; 91 lëndë kanë qenë të pranuar ndërsa 11 lëndë kanë qenë të refuzuara.

Në këtë shërbim shfrytëzues të ndihmave sociale janë edhe minoritetet nga të cilat: 02 familje serbe, 51 familje egjiptiane, 21 familje ashkali ,05 rome, 15 familje boshnjake si e dhe 25 tjerë,të cilët nuk janë deklaruar por janë nga minoritetet pakicë e të cilat janë të shpërndarë nëpër fshatrat e Komunës së Istogut dhe mbulohen me terrene nga nëpunësit e ndihmave sociale të QPS-së. Këtu vlenë të theksohet se numri minoriteteve është edhe më i madh mirëpo disa aplikantë nuk dëshirojnë të deklarohen se cilës përkatësi etnike i takojnë.

Numri i familjeve të riaplikuara. Gjatë periudhës raportuese kanë riaplikuar gjithsejtë për 1154 lëndë ku prej tyre 406 kanë qenë të kategorisë së parë si dhe 738 lëndë të kategorisë së dytë. Nga këto 1053 lëndë kanë qenë të aprovuara si dhe 10 të ndërprera.**Lëshimin e vendimeve.** Gjatë periudhës raportuese vjetore për vitin 2019 janë lëshuar gjithsejtë 1504 vendime nga këto 1251 vendime kanë qenë pozitive si dhe 151 negative.

SHËRBIMET REZIDENCIALE

Strehimi në shtëpitë për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje.....03

SHERBIME FAMILJARE

1. Fëmijët e braktisur.....	00
2. Fëmijët me sjellje asociale.....	02
3. Abuzimi seksual i të miturve.....	00
4. Kujdestaria për të mitur.....	00
5. Kujdestaria për të rritur.....	01
6. Strehimi në familje alternative.....	01
7. Strehimet për rehabilitim e riintegrim të viktimave në familje e komunitet	
8. Dhënia e këshillave familjare.....	37
9. Ndihma në rregullimin e marrëdhënieve bashkëshortore e familjare.....	42
10. Dhënia e mendimit për besimin e fëmijëve.....	21
11. Dhënia e mendimit për martesën e miturve.....	03
12. Personat me nevojë të veçanta.....	01
13. Ndihma për realizimin e kontaktimit mes fëmijëve e prindërve të ndarë-shkurorëzuar.....	02
14. Shërbimet për fëmijët e rrëmbyer me element vendor.....	01

15. Fëmijët me aftësi të kufizuara.....	13
---	----

SHËRBIMET E KRIMEVE PËR GJYKATË

1. Shërbimet për fëmijët në konflikt me ligjin(delikuenca).....	08
---	----

SHËRBIME ADIMINISTRATIVE

1. Certifikatë/Dëshmi që pala nuk ka obligime financiare ndaj personave fizikë.....	188
2. Pëlqimi për dokument të udhëtimit	09
3. Regjistrimi i mëvonshëm i fëmijëve	304
4. Certifikatë se nuk i është marrë aftësia e veprimit	185
5. Pëlqimi për bartje të pasurisë.....	01
6. Konstatime zyrtare.....	10

SHTËPIA E KOMUNITETEVE NË GJURAKOC

Në Shtëpinë e komuniteteve në Gjurakoc për momentin janë të vendosur 17 rezidentë nga të cilët, 4 nga Komuna e Istogut, 4 nga Komuna e Pejës, 2 nga Komuna e Gjakovës, 2 nga Komuna e Deçanit, 4 nga Komuna e Klinës dhe një nga Komuna e Junikut. Nga numri i përgjithshëm i të vendosurëve, 14 janë të nacionalitetit shqiptar, një i komunitetit rom dhe një i komunitetit boshnjak.

XII. DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE MBROJTJE DHE SHPËTIM

Në kuadër të Drejtorisë për Shërbime publike, Mbrojtje dhe Shpëtim funksionojnë këto sektore: Sektori i Shërbimeve Publike dhe Sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor-2019 në Drejtorinë për Shërbime publike, Mbrojtje dhe Shpëtim nga ana e palëve gjegjësishtë nga qytetarët na janë parashtruar gjithsej 770 kërkesa, nga ato kërkesa janë :

- Të miratuara 413
- Të refuzuara 356

- Në Proces 3
- TOTALI: 770

Kërkesat e parashtruara nga palët, gjegjësisht qytetarët janë të natyrave të ndryshme dhe atë për:

Licencë Auto-Taxi,

Kërkesa për furnizim me gypa të ujësjellësit dhe kanalizimit;

Kërkesa për furnizim me material ndërtimor për raste emergjente;

Kërkesa nga lëmia e komunikacionit (transport , sinjalizim);

Kërkesa për furnizim me Zhavorr ;

Kërkesë për prerje Asfalti;

Kërkesa për masat mbrojtëse nga zjarri;

Kërkesa për kryerjen/moskryerjen e shërbimit ushtarak;

Kërkesa për dru zjarri, furnizim me ujë të pishëm, kërkesa për strehim dhe ndihmë në ndërtimin e shtëpive etj.

SEKTORI I SHËRBIMEVE PUBLIKE:

Gjatë kësaj periudhe vjetore bazuar në kërkesat e qytetarëve kemi dal në terren duke shqyrtuar dhe analizuar të gjitha rastet varësisht prej mundësive buxhetore iu kemi dal në ndihmë duke u bazuar në kontratat e aktiviteteve të ndryshme të cilat përmbushin edhe kërkesat e qytetarëve qofshin ato furnizim me zhavorr, furnizim me material ndërtimor, furnizim me gypa te ujësjellësit dhe kanalizimit etj. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe vjetore është përgatitur dokumentacioni me kohë për shpalljen e të gjithë tenderëve të paraparë në plan buxhetin e vitit 2019 për DSHPMSH **dhe janë realizuar këto projekte:**

- Ndërtimi i shtëpive për të pastrehë në komunën e Istogut (92,000.00€),
- Mirëmbajtja e ndriçimit publik (20,000.00€),
- Ndërtimi i ndriçimit publik në Saraderan (8,851.00€),
- Ndërtimi i ndriçimit publik në Istog (11,571.00€),
- Ndërtimi i trotuarit Vrellë - Studenicë (36,706.20€),
- Ndërtimi i trotuarit Istog - Dushkajë -Dubravë (17,415.00€),
- Ndërtimi i trotuarit Vrellë - Stupe -Kamenicë (14,751.50€),
- Ndërtimi i trotuarit Bellopojë - Veriq (18,853.50€),
- Ndërtimi i trotuarit Orroberdë-lagja Hakaj-shkollë(26,939.00€)
- Ndërtimi i trotuareve ne Saradran (27,251.00€)
- Ndërtimi rrethojave të varrezave ortodokse(4,690.00€)
- Ndërtimi i kanalizimit në Istog-Lagjet e reja-Faza e dytë (~17,000.00€),
- Ndërtimi i kanalizimit në Shushicë (8,757.60€),
- Sinjalizimi Horizontal dhe vertikal (35,000.00€),
- Eliminimi i mbeturinave nga hapësirat publike (8,950.00€),
- Sanimi i gjendjes nga fatkeqësitë natyrore (41,730.00 €),

- Ndërtimi i deponisë në Tuqep (9,770.00€),
- Mirëmbajtja e rrugëve lokale të rendit të IV-të (29,000.00€),
- Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale të asfaltuara (5,000.00€),
- Blerja dhe furnizimi me gypa të kanalizimit dhe ujësjellësit (30,000.00€).
- Ndërtimi i kanalizimit në Kashicë (~16,000.00€),
- Ndërtimi i kanalizimit në Dubovë të Vogël (24,896.00€),
- Ndërtimi i mureve mbrojtëse në Syriganë, Mojstir dhe Shushicë (9,959.00€),
- Ndërtimi i urës në fshatin Kerrninë (4,417.00€),
- Mirëmbajtja e kamerave (9,973.00€),

Po ashtu në aspektin profesional ne si sektor kemi qenë të kyçur në kryerjen e shumë projekteve-paramasa dhe parallogaritë, gjithashtu kemi qenë të kyçur në komisione për vlerësimin e tenderëve tjerë si dhe në mbikëqyrje të projekteve të ndryshme dhe në verifikime të punimeve për projekte të ndryshme.

Po ashtu në këtë periudhë vjetore është bërë trajnimin për grumbullimin dhe futjen e të dhënave në softuerin ENMASOFT nga AKEE dhe GIZ .

Janë mbledhur të dhënat e objekteve të komunës të cilat konsumojnë energji të dhënat janë futur në softuerin ENMASOFT

Në bashkëpunim me GIZ, Komuna e Istogut dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës për dy muaj janë angazhuar dy praktikantë profesional për të futur të dhënat në sistem. GIZ ka të angazhuar një kompani konsulentë që po ndihmon në grumbullimin e të dhënave të objekteve të Komunës së Istogut. Të dhënat janë të vendosura në një pyetësor që mandej këto të regjistrohen në softuerin ENMASOFT. Të dhënat që përpunohen janë : të dhënat klimatike ,të dhënat themelore për ndërtesën, të dhënat ndërtimore, ngrohja, përgatitja e ujit sanitar, kondicionimi i ajrit dhe ndriçimi. Të gjitha ndërtesat janë të ndara në :institucione administrative, ndërtesa për veprimtari arsimore, ndërtesa për veprimtari shëndetësore, ndërtesa për veprimtari kulturore, ndërtesa e kujdesit social, ndërtesa për veprimtari sportive. Në Komunën e Istogut janë të regjistruara 61 ndërtesa të komunës që konsumojnë energji. Konsumi i energjisë është në ngrohje, në energji elektrike, ndriçim, uji i rrjedhshëm dhe karburant të automjeteve që menaxhohen nga komuna. Deri tani janë grumbulluar të dhënat dhe janë futur në sistem për konsumin e energjisë elektrike për tri vitet e fundit 2016,2017,2018 në 61 objekte të komunës dhe të ndriçimit publik që janë në 98 njehsorë elektrik. Kjo punë është arritur duke pasur qasje online në KEDS, ne kemi hapur llogari (email) në kompaninë për shpërndarjen e energjisë- KEDS dhe marrim të dhëna për çdo njehsor të energjisë elektrike të objekteve komunale si shkolla, çerdhe dhe kopshte, ndërtesa administrative, kulturore ,sportive , shëndetësore dhe ndriçimin publik .Janë grumbulluar të dhënat për konsumin e ujit të rrjedhshëm për të gjitha objektet e Komunës së Istogut me 88 njehsorë të ujit , këto të dhëna merren nga KUR Hidro Drini e të gjitha këto janë futur në ENMASOFT për vitet 2016,2017,2018. Janë grumbulluar të dhënat për konsumi të energjisë për ngrohje për të gjitha objektet, ndërtesat komunale të lëndëve djegëse, dru, naftë, pellet, energji elektrike për vitin 2016,2017 dhe 2018. Përveç të dhënave që jemi duke i futur në sistem në të njëjtën kohë në bashkëpunim me GIZ-in dhe kompaninë konsulente jemi duke përgatitur PVEE. Për Komunën e Istogut është formuar

grupi i punës nga Kryetari për hartimin e PVEE-së. Kemi bërë trajnime të vazhdueshme për përdorimin e softuerit dhe të përgatitjes së raporteve për menaxhimin e energjisë. Prej të gjitha aktiviteteve e deritanishme kemi përgatitur “ Planin Komunal për Eficiencë të Energjisë” i cili dokument është miratuar në Kuvendin Komunal të Istogut.

SEKTORI PËR MBROJTJE DHE SHPETIM

Realizimi i numrit të përgjithshëm të interven, struktura e zjarreve dhe int.tjera 2019													
2019	Nr.i përgj. i daljeve	Nr.i zjarreve	Nr. i Teknike	Nr.i shërbimeve	Aksidente rrugore	Vërshime	Të rejsh	Të lënduar			Të vdekur		
								zj.	qyt.	tot	zj.	qyt.	tot
Janar	15	10	4	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0
Shkurt	30	25	4	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0
Mars	100	97	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Prill	21	20	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Maj	10	5	5	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Qershor	16	6	8	0	0	2	0	0	0	0	0	0	0
Korrik	17	4	11	0	2	0	0	0	5	5	0	0	0
Gusht	34	13	19	0	2	0	0	0	9	9	0	1	1
Shtator	45	15	30	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Tetor	53	18	32	0	2	0	1	0	5	5	0	1	1
Nëntor	19	3	16	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Dhjetor	10	2	8	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjithsejtë	370	218	141	0	6	4	1	0	19	19	0	2	2

KATEGORIZIMI I ZJARREVE DHE INTERVENIMEVE SIPAS MUAJVE GJATË VITIT 2019														
	LLOJI I INTERVENIMIT	Jan.	Sh ku.	Mar .	Prill	Maj	Qer sh	Kor r.	Gus h.	Sht a.	Tet .	Në nt.	Dhj e.	GITHË SEJ.
1	ZJARRË	10	25	97	20	5	6	4	13	15	18	3	2	218
2	INTERVENIME TEKNIKE	4	4	3	1	5	8	11	19	30	32	16	8	141
3	SHËRBIME	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
4	AKSIDENTE KOMUNIKACIONI	0	0	0	0	0	0	2	2	0	2	0	0	6
5	VËRSHIME	1	1	0	0	0	2	0	0	0	0	0	0	4
6	ALARME TË RREJSHME	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	1
	Gjithësejtë:	15	30	100	21	10	16	17	34	45	53	19	10	370
1. Ndarja analitike e zjarreve në : OBJEKTE NDËRTIMORE														
1. 1	Banesa – shtëpi	2	0	0	0	0	2	0	1	0	1	0	1	7

1. 2	Objekte ndimëse	1	0	0	1	2	1	1	0	0	1	0	0	7
1. 3	Plevica - shtalla	0	2	0	0	1	0	0	0	2	0	0	0	5
1. 4	Objekte kolektive (banesa)	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
1. 5	Oxhaqe	0	2	1	1	0	0	0	0	0	0	2	1	7
1. 6	Të tjera	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Gjithësejtë:	3	4	1	2	3	3	1	1	2	2	2	2	26
2. Ndarja analitike e zjarreve në: OBJEKTE EKONOMIKE														
2. 1	Publike	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
2. 2	Objekte Biznesi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2. 3	Objekte Indusiale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2. 4	Të tjera	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
	Gjithësejtë:	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
3. 1	Paisjet elektrike / trafo	1	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	2
3. 2	Paisjet shpërndarëse	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	1
3. 3	Gjenerator	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
3. 4	Të tjera	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Gjithësejtë:	1	0	0	1	0	0	0	1	0	0	0	0	3
4. Ndarja analitike e zjarreve në: SIPËRFAQE TË HAPURA														
4. 1	Mal	1	3	42	10	0	0	0	4	1	1	0	0	62
4. 2	Sipërfaqja e djegur (hektar)	2.0 0	5.0 0	390. 00	45, 00	0	0	0	54. 00	6.0 0	10. 00	0	0	522.00
4. 3	Bari i thatë	2	8	35	3	0	2	1	3	8	10	1	0	73
4. 4	Sipërfaqja e djegur (hektar)	3.5 0	21. 00	160. 00	6,0 0	0	6.00	5.0 0	28. 00	21. 00	15. 00	2.0 0	0	267.50
4. 5	Sipërfaqe bujqësore	0	7	10	1	0	0	0	3	4	0	0	0	25
4.	Sipërfaqja e djegur (	0	7.0	22.0	3,0	0	0	0	15.	8.0	0	0	0	55.00

6	hektar)		0	0	0				00	0				
4.7	Të tjera	2	3	9	2	2	1	2	1	0	4	0	0	26
5. Ndarja analitike e zjarreve në: AUTOMJETE TRANSPORTI0														
5.1	Automjete motorrike	0	0	0	1	0	0	0	0	0	1	0	0	2
	Gjithësejtë:	0	0	0	1	0	0	0	0	0	1	0	0	2
6. Ndarja analitike: INTERVENIMEVE TEKNIKE														
6.1	INTERVENIME TEKNIKE	4	4	3	1	5	8	11	19	30	32	16	8	141
6.2	SHËRBIME	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
6.3	AKSIDENTE RRUGORE	0	0	0	0	0	0	2	2	0	2	0	0	6
6.4	VËRRSHIME	1	1	0	0	0	2	0	0	0	0	0	0	4
7. Të lënduar														
7.1	Zjarrfikës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
7.2	Qytetarë	0	0	0	0	0	0	5	9	0	5	0	0	19
	Gjithësejtë:	0	0	0	0	0	0	5	9	0	5	0	0	19
8. Të vdekur														
8.1	Zjarrfikës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
8.2	Qytetarë	0	0	0	0	0	0	0	1	0	1	0	0	2
	Gjithësejtë:	0	0	0	0	0	0	0	1	0	1	0	0	2
9. Prona:														
9.1	Shoqërore	4	2	43	3	1	3	10	6	3	8	17	1	101
9.2	Private	11	22	45	18	5	10	6	24	38	40	2	5	226
10. Pjesmarrja e zjarrfikësve:														
10.1	Zjarrfikësa aktiv	34	62	184	42	19	28	31	46	61	77	26	19	629
10.2	Zjarrfikësa vullnetar	0	0	0	0	0	16	10	20	25	24	10	6	111
11. Mjetet e përdorura:														
11.1	Komanduese	3	4	10	4	3	3	3	8	5	5	4	3	55
11.2	Sulmuese	4	6	75	15	3	4	4	12	15	20	3	5	166

11.3	Tanker	7	5	14	4	5	3	6	15	30	25	16	5	145
11.4	Teknike	3	4	2	2	2	6	3	5	4	13	0	0	45
11.5	Transportuese	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
11.6	Emergjente	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		0
12. Mjete të shpenzuara:														
12.1	Ujë / m³	82	25	163	35	41	38	55	112	167	188	76	37	1019
12.2	Shkumë / lit.	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
12.3	Pluhur / kg.	9	0	0	18	18	0	0	25	0	18	0	9	88
12.4	CO2 / kg	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
12.5	Mjete tjera	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
13. Orë pune:														
13.1	Orë pune	73	51	232	95	25	25	55	107	106	75	27	29	903
13.2	Minuta	30	20	20	50	10	05	30	10	00	05	05	15	15
	GJITHËSEJTË:	73,30	51,20	232,20	95,50	25,10	25,05	55,30	107,10	106,00	75,05	27,05	29,15	903,15

XIII. ZYRA KOMUNALE PËR KOMITETE DHE KTHIM

Gjatë peridhës së lartëcekur, ZKKK-ja në Komunën e Istogut ka pranuar gjithsej 100 lëndë. Kemi realizuar vizita në terren, kemi pasur takime me organizata të huaja dhe vendore lidhur me realizimin e projekteve që ka ZKKK-ja.

Në kuadër të punëve të rregullta, ZKKK kryen edhe punë të tjera si në vijim:

- Angazhohet për integrimin e të gjitha komuniteteve në komunë tonë, duke iniciuar çështjen e bashkëjetesës së komuniteteve pakicë me atë shumicë;
- Merr pjesë në mbledhjet e Komiteteve si: Komitetin për Komunitete dhe në këtë Komitet kontribuon dhe mbronë interesat e të gjitha komuniteteve të cilat jetojnë dhe punojnë në Komunën e Istogut.

- Bashkëpunon me Ministrin për Komunitete dhe Kthim me qëllim të realizimit të shumë projekteve në të mirë të të gjitha bashkësive minoritare etnike dhe bashkësive të tjera;
- Viziton familjet të cilat janë kthyer nga shtetet fqinje dhe vendet tjera me qëllim që të njihet me problemet e tyre në të cilat ata hasin dhe integrimin e tyre në shoqërinë kosovare. Gjithashtu viziton edhe familjet që ende gjenden në hapësirat e shteteve fqinje, ku bisedon me ata persona të shpërngulur dhe njëkohësisht i njofton me mundësinë e kthimit dhe mënyrën si mund të kthehen ata.
- Bashkëpunon me organizatat joqeveritare të cilat merren me kthimin e personave të kthyer siç janë: UNHCR, IOM, USAID, OSCE, DRC etj.

KTHIMI I PERSONAVE TË ZHVENDOSUR

Personat e zhvendosur, Gjatë këtij viti, kemi pasur gjithsej 23 kërkesa pranë ZKKK-së nga personat e zhvendosur. **Personat të zhvendosur brenda vendit**. Nga kjo kategori nuk kemi pasur asnjë kërkesë të parashtruar në ZKKK **Personat e zhvendosur në rajon**, Nga kjo kategori nuk kemi pasur asnjë kërkesë të parashtruar në ZKKK

Komisioni Komunal për Kthim (KKK)i formuar me vendim të Kryetarit të Komunës duke u bazuar në Rregulloren (QRK) - Nr.01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme, ky komision ka për qëllimin shqyrtimin e kërkesave të parashtruara nga personat e zhvendosur dhe të njejtat pastaj t'i rekomandojë në Komisionin Qëndror Shqyrtues (KQSH). KKK ka shqyrtuar gjatë këtij viti gjithsej 23 kërkesa, ndërsa duke u bazuar në dokumentacionin e parashtruar nga PZH-të, komisioni ka rekomanduar për shqyrtim 13 raste në KQSH e cila ka aprovuar 13 rekomandimet e KKK-së për ndërtim të shtëpive të PZH-ve, dhe tani jemi në fazën e pritjes së punëve nga kompanit kontraktuese.

RIINTEGRIMI I PERSONAVE TË RIATHDESUARGjatë periudhës raportues, duke u bazuar në Sistemin e Menaxhimit të Rasteve (SMR), në Komunën e Istogut kemi pasur **3 individë** të riatdhesuar, **6 familje** të riatdhesuara apo në tërësi kemi pasur **32 persona** të riatdhesuar.Në bashkëpunim me Zyrtarin e Lartë Regional për Riintegrim dhe sëbashku me Zyrtarë nga Qendra për Punë Sociale në Komunën e Istogut, kemi realizuar vizita të njëpasnjëshme tek familjet e riatdhesuara duke vlerësuar nevojat e tyre për riintegrim të qëndrueshëm, gjithashtu duke i këshilluar dhe asistuar në kompletimin e procedurave për përfitim nga PROGRAMI i Qeverisë së Republikës së Kosovë për Personat e Riatdhesuar.**Kërkesa të parashtruara pranë ZKKK-së**. Gjatë këtij viti pranë ZKKK-së nga persona të riathdhesuar kemi pasur gjithsej 13 kërkesa të parashtruara, prej tyre: 8 për **pagesë të qirasë për banim**, 1 për **Asistencë Sociale**, 3 për **pako dimri (dru zjarri)** dhe 1 për **trajtim mjekësor**. **Komisioni Komunal për Riintegrim (KKR)**. Ky komision është i formuar nga Kryetari i Komunës dhe duke u bazuar në Rregulloren (QRK) 13/2017 Për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, ka kompetenca vendimmarrëse për kërkesat e parashtruara nga personat e riatdhesuar.Ky komision gjatë këtij viti ka mbajtur gjithsej 9 mbledhje, ka shqyrtuar gjithsej 13 kërkesa nga personat e riatdhesuar, ka aprovuar gjithsej 13 kërkesa, ka revokuar 1 kërkesë me rekomandim të Zyrtarit të Lartë Rajonal për Riintegrim.

AKTIVITETET E PLANIFIKUARA. Në kuadër të Planit të Punës së ZKKK-së, duke u bazuar në kompetencat e saj, ka planin e punës, në të cilin përfshihen planifikimet për aktivitetet të cilat presin që të realizohen gjatë vitit. Planifikon dhe menaxhon me të gjitha kodet buxhetore me përjashtime të shpenzimeve komunale. Me poshtë i gjeni të renditura aktivitetet e planifikuara:

- Ndërtimi i kanalizimit në Llukac të Begut;
- Ndërtimi i rrugës Shalinovic – Zallq;
- Riparimi dhe zgjerimi i rrugës “Lopcanska” – Osojan;
- Asfaltimi i rrugës në Cerkoz, bashkëfinancim me IOM;
- Asfaltimi i rrugës “Drenusha” në Lubovë;
- Asfaltimi i rrugëve të rendit IV.

AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

- ✓ Ndërtimi i kanalizimit në Llukac të Begut;
- ✓ Riparimi dhe zgjerimi i rrugës “Lopcanska” – Osojan;
- ✓ Asfaltimi i rrugës në Cerkoz, bashkëfinancim me IOM;
- ✓ Asfaltimi i rrugëve të rendit IV.

AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM

- ➔ Ndërtimi i rrugës Shalinovic – Zallq dhe
- ➔ Asfaltimi i rrugës “Drenusha” në Lubovë.

AKTIVITETE DHE PROJEKTET E TË PËRBASHKËTA ME OJQ VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE

Në kuadër të Programit ROMACTED të Zyrës së Këshillit të Evropës, implementues i të cilit është OJQ “Advancing Together” – AT, ZKKK ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Zyrën e Këshillit të Evropës për bashkëfinancim të projektit “Ndërtimi i kanalizimit në lagjen Serbobran” – Istog. ZKKK do të financojë 55% të totalit të projektit dhe pjesa e tjetër do të financohet nga Zyra e Këshillit të Evropës në kuadër të projektit ROMACTED. Ky projekt është në fazën e tenderimit dhe shumë shpejt pritet të përfundojnë procedurat. Në kuadër të Projektit “SUREP” të Caritasit Zviceran, komponenta psiko-sociale e cila ka për qëllim mbështetjen e familjeve/personave të riatdhesuar të cilët kanë nevojë për mbështetje psiko-sociale, është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në mes të Caritasit të Zvicrës dhe ZKKK-së për bashkëfinancim të këtij projekti. ZKKK do të bashkëfinancojë 30% prej shumës totale të projektit. Asfaltimi i rrugës në Cerkoz, bashkëfinancim me IOM-in.

LËNDËT E PRANUARA NË ZKKK, TË APROVUARA, TË REFUZUARA DHE NË PROCES

ZKKK gjatë këtij viti ka pranuar një numër kërkesave të natyrave të ndryshme. Sipas SIK, gjatë kësaj periudhe raportuese ka pranuar gjithsej 63 kërkesa të llojit si: riparim të rrugëve me zhavorr, ndihmë financiare, ndihm për mbulim të shpenzimeve mjekësore, ndihmë për pagesë të banimit me qira etj. Në bazë të mundësive buxhetore dhe ligjore, zyra ka realizuar shumicën e këtyre kërkesave. **SFIDAT.** Zyra, sikur të gjitha drejtoritë/ zyrët tjera gjatë realizimit të planit të saj të punës. Ndër sfidat kryesore vazhdon të jetë ndihma për personat e riatdhesuar nga vendet e treta. Pas përfundimit të periudhës së banimit me qira 6+6 muaj për këtë kategori, sipas Rregullorës QRK 13-2017, personat e riatdhesuar kalojnë në kompetencë dhe përgjegjësi të Komunës. Këta persona vazhdojnë të jenë në vështirësi ekonomike e sociale edhe 1 vit pas riatdhesimit të tyre. Në muajin Nëntor, 2019 nga Kuvendi Komunal në Istog është aprovuar Plan i Lokal i Veprimit për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar, i cili është i bazuar në Strategjinë Kombëtare për Riintegrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar në Kosovë dhe ka për qëllim lehtësimin dhe asistim në riintegrimin të kësaj kategorie në shoqërinë kosovare. Besojmë në marrjen përsipër të përgjegjësisë nga të gjitha drejtoritë/zyrët të cilat i përfshin ky Plan Lokal i Veprimit në mënyrë që t'iu mundësojmë një jetë më të mirë kësaj kategorie.